Потребите на оваа популација се различни и не секое психичко нарушување бара медикаментозен третман. Иако психијатриските лекови можат да помогнат, постои ризик од нивна несоодветна употреба како средство за контрола на однесувањето. Ова, особено ги прави децата во пеналниот систем ранливи на прекумерна терапија, имајќи ја предвид нивната ограничена можност за избор. Оттука, систематскиот скрининг и проценката на менталното здравје и психосоцијалните потреби претставуваат клучен предуслов за обезбедување соодветна грижа и поддршка.

Во установата беа идентификувани деца со специфични здравствени и развојни потреби, за кои е обезбеден соодветен третман и заштита од стигматизација. Беа реализирани индивидуални контакти со дел од присутните деца, во услови што овозможуваат доверливост и непречена комуникација. Сите беа од машки пол, при што доминираат припадници на етничките малцинства. Образовното ниво е ниско, значителен дел од децата се со незавршено основно образование и ограничени вештини за писменост.

Здравствената заштита во установата се обезбедува преку општ лекар кој е присутен еднаш неделно и ги упатува децата на дополнителни специјалистички, вклучително и психијатриски прегледи. Достапна е и стоматолошка услуга за основна нега во рамки на установата. Во соработка со здравствени институции, обезбедена е психијатриска грижа по потреба.

Како позитивна новина е ангажманот на медицински техничар со полно работно време, кој по потреба интервенира и надвор од редовното работно време. Во отсуство на лекар, се повикува итна медицинска помош. Сепак, овде мора да се нотира дека техничарот не поминал претходна обука за работа со деца во ризик.

Првичните здравствени прегледи се вршат во краток рок по приемот, но не вклучуваат тестирања за дрога ниту целосен увид во претходна медицинска документација (вклучително и заразни болести). Не се води евиденција за вакцинален статус на децата, што претставува сериозен пропуст. Терапијата ја администрира медицинскиот техничар, а во негово отсуство тоа го прави друг персонал, врз основа на претходно подготвени дози. Забележано е подобрување во начинот на распределба и евиденција на терапијата, која се води електронски. Ампуларна терапија се дава исклучиво по налог на лекар. Поголем дел од децата примаат одредена терапија во текот на денот. Во однос на набавката на витамини, таа се врши од страна на медицинскиот техничар, со последователна рефундација од установата.

Ментално здравје и психосоцијални потреби:

Децата сместени во ВПД Тетово генерално изразија задоволство од условите во установата. За разлика од претходните наоди, не беа искажани поплаки за ограничен пристап до телефон или слободни активности, туку беше наведено дека имаат редовна комуникација и поддршка од воспитувачите. Кај децата се забележуваат различни нивоа на ментална и емоционална состојба, што влијае врз нивната адаптација и ресоцијализација. Најчесто се присутни симптоми на анксиозност и депресија (страв, несоница, безнадежност), потешкотии со контрола на агресија, како и ниска самодоверба.

Кај значителен дел од децата се поставени психијатриски дијагнози, најчесто поврзани со анксиозни нарушувања, нарушувања на спиењето, зависности и нарушувања во однесувањето. Дел од децата примаат фармаколошка терапија, при што доминира употреба на анксиолитици и терапија за спиење, додека помал број се на посложена психијатриска терапија или антидепресиви. Присутни се и случаи со соматски здравствени проблеми.

Психијатриските услуги се обезбедуваат надвор од установата, што ја ограничува доверливоста и континуитетот на третманот. Контролните прегледи не се редовни, а дополнителен предизвик претставува тоа што третманот го спроведуваат психијатри за возрастни, наместо специјалисти за детска и адолесцентна психијатрија.

Доминираат психолошки потешкотии како загриженост, напнатост, негативна слика за себе и деструктивни реакции на стрес. Забележани се и повреди како резултат на импулсивни реакции. Дел од децата имаат историја на злоупотреба на психоактивни супстанции, при што не постои систематски третман за апстиненцијални состојби. Сепак, децата препознаваат и позитивни механизми за справување, како спортски активности, музика, меѓусебна поддршка и контакт со семејството. Особено се истакнува интересот за вокациски обуки и потребата од нивно унапредување.

Медицинската документација генерално е уредно водена, но беа забележани одредени пропусти, како отворање повеќе картони за исто дете и мешање на медицински извештаи помеѓу досиеја. Во установата не се применува терапија со психостимуланси, поради нивна достапност, иако постојат индикации дека дел од популацијата би имала потреба од ваков третман. Од достапната терапија, најчесто се користат анксиолитици и средства за спиење, додека помал број деца се на посложена психијатриска терапија. Забележани се ризици поврзани со полимедикација, како и можност за развој на толеранција и зависност, особено кај анксиолитиците. Поради тоа, неопходен е редовен медицински мониторинг, внимателно следење на ефектите од терапијата и разгледување на алтернативни, нефармаколошки пристапи, вклучително и психотерапија.

Менталната здравствена состојба на децата е комплексна и бара континуирана стручна поддршка, како и координиран пристап помеѓу здравствениот персонал и воспитувачите, со цел подобрување на нивната адаптација и ресоцијализација.

Заклучни согледувања и препораки:

Наодите во голема мера се совпаѓаат со претходните анализи, што укажува на потреба од доследна имплементација на веќе дадените препораки, дополнети со нови насоки. Посебно внимание треба да се посвети на долготрајната употреба на анксиолитици поради ризик од зависност, когнитивни потешкотии и седативни ефекти. Терапијата треба да се спроведува под строг медицински надзор, со можност за постепено намалување и замена со алтернативни пристапи.

Се препорачува зајакнување на нефармаколошките интервенции, како психотерапија, физичка активност, техники за справување со стрес и структурирани психосоцијални програми. Особено значајно е воведување редовни индивидуални, групни и семејни интервенции, како и засилен третман за лица со зголемен ризик.

Дополнително, потребно е:

- унапредување на психолошката поддршка и редовни стручни третмани;
- развој на образовни, социјални и вештински програми;

- активно вклучување на семејствата во процесот на ресоцијализација;
- ангажирање дополнителен стручен кадар и користење ресурси од заедницата;
- воспоставување јасни протоколи за фармаколошки третман и следење на здравствената состојба;
- развој на протоколи за третман на зависности и апстиненцијални состојби;
- обезбедување формално образование и програми за описменување;
- поттикнување на вокациски обуки и соработка со локалната економија;
- организирање спортски и културни активности;
- континуирана едукација и супервизија на персоналот.

Како дополнителни мерки се препорачува воведување здравствени скрининзи при прием, подобрување на медицинската евиденција и обука на персоналот за работа со деца во ризик.

Табела бр.2

ПРЕПОРАКИ ЗА ПОДОБРУВАЊЕ НА КОНСТАТИРАНИТЕ СОСТОЈБИ упатени до Управа за извршување на санкции		
Ред. бр.	Препорака:	Одговори:
1	Преземање на конкретни мерки со коишто ќе се осигура дека децата од женски пол на кои со правосилна одлука им е изречена воспитна мерка упатување во воспитно-поправен дом да бидат сместени во установа на еднаква основа како и децата од машки пол;	Имајќи предвид дека е неопходно физичко одвојување на просторот во ВПД Тетово со цел да се оневозможи мешање на машки и женски деца, информираме дека во тек се активности за адаптирање и обезбедување на услови во ВПД Тетово за да може безбедно и децата од женски пол на кои им е изречена мерката упатување во воспитно поправен дом да ја издржуваат мерката во оваа установа. Исто така, би сакале да додадеме дека со договор на дело ангажирани се две лица од женски пол како припаднички на затворска полиција, кои поминаа обука (со ментори) во женското одделение во КПД Идризово.
2	Воспоставување редовни обуки за човекови права, третман на ранливи категории и превенција на тортура.	Неопходно е зголемување на бројот на вработените во сите установи, вклучително и во ВПД Тетово. Врз основа на потребата од вработувања што ја имаат установите и годишните планови за вработувања што секоја установа согласно закон ги доставува до Управата за извршување на санкциите, се изработува Обединет годишен извештај за вработување во целиот затворски систем и истиот се доставува до надлежните институции за добивање на согласност за вработување. Меѓутоа, би сакале да нагласиме дека постои голема разлика од потребата од нови вработувања која ние како Управа за извршување

		<p>на санкциите ја детектираме и истата е прсликана во Обединетиот годишен извештај за вработување на затворскиот персонал до согласностите кои се добиваат. Конкретно за ВПД Тетово согласно Годишниот план за вработување и унапредување на затворски персонал за 2025 година се одобрени само две унапредувања</p> <p>Што се однесува до обуките, информираме дека вработените од одделението за третман во ВПД беа запознати со Програмата за меки животни вештини во рамки на проектот „Зајакнување на процесот на рехабилитација и реинтеграција на децата во системот на правда на децата (СППМД и УНИЦЕФ). Програмата се применува како дел од групната работа со децата. Дополнително, вработените присуствуваа и на консултативна работилница за програми за ресторативна правда и програми за превенција/реинтеграција на деца во ризик и деца во судир со закон во рамките на проектот „Правда за деца». Реализирани се активности за обука и запознавање со овие програми. Нивната формална имплементација во ВПД Тетово сè уште не е воспоставена.</p> <p>Во насока на зајакнување на третманот и грижата за децата, Управата за извршување на санкции склучи Меморандум за соработка со Центарот за социјални иницијативи „Надеж», во чии рамки ќе се спроведуваат: едукативни програми, обуки за рецидивизам, обуки за животни вештини, менторски програми, програми за родителство и семејство.</p> <p>Согласно постојната програма за обука, не располагаме со соодветен капацитет за спроведување на специјализирани обуки, но во иднина ќе се побара стручна помош од надворешни експерти, кои би можеле да организираат обуки за третман и поддршка на деца во ризик.</p>
3	<p>Во комуникација и координација со Министерството за образование и наука да се преземат итни мерки за вклучување на децата во процесот на формалното образование. за потребите на граничните полициски станици.</p>	<p>Во Законот за изменување и дополнување на Законот за основно образование („Службен весник на РСМ“ бр.3/2025) е предвидено дека Основното училиште за возрасни „Антон Семјонович Макаренко» Скопје, кое добива статус на државно училиште ќе треба да го спроведе основното образование на децата во воспитно-поправните установи. Управата за извршување на санкции изготви Анализа на состојбата со степенот на образование на лицата во КПУ и ВПУ, која е доставена до Министерството за образование и наука како основа за организирање на учебната 2025/2026 година.</p>

Табела бр.3

ПРЕПОРАКИ ЗА ПОДОБРУВАЊЕ НА КОНСТАТИРАНИТЕ СОСТОЈБИ упатени до ВПД Тетово		
Ред. бр.	Препорака:	Одговори:
1	<p>Да се преземат мерки заради олеснување на пристапот до воспитно-поправниот дом, како на пример комуникација со локалните власти за воспоставување на редовна и честа автобуска линија, како и непосредна комуникација и поддршка во организирањето на посетата за членовите на семејствата и други блиски лица на децата сместени во Домот;</p>	<p>Организирањето на јавен автобуски превоз и детерминирање на автобуски линии е во надлежност на локалната самоуправа. Од тие причини, во неколку наврати се реализирани работни состаноци со градоначалникот на општина Брвеница, на кои, покрај останатите прашања, се дискутираше и на оваа тема. Од општинските власти не е добиен потврден одговор за организирање на јавен превоз. Од тие причини заедно со Здружението на граѓани Рубикон-Скопје, во рамки на проектот „Поддршка на деца во конфликт со законот», се реализираше проектна активност организирање и реализирање на посети од страна на биолошките семејства, односно старателите и членовите на семејствата на децата кои престојуваат во Домот во текот на 2022 и 2023 година, при што од страна на Здружението на граѓани Рубикон - Скопје беше организиран превоз за сите деца чии родители, старатели или членови на семејства покажаа интерес и желба да остварат посета на Домот и средби со своите деца, но и разговори со стручните лица на Домот. Исто така, од страна на раководителот на одделението за третман, преку писмено обраќање до надлежните Центри за социјална работа е иницирано доделување на еднократна парична помош на семејствата во финансиски ризик заради остварување средби со своите деца кои се сместени во Домот.</p>
2	<p>Упатството за дисциплинска одговорност да се ревидира во насока на дефинирање на правата што ги има детето во текот на дисциплинската постапка, особено во однос на можноста за жалба против одлуките на директорот за изрекување воспитна мерка, како и во однос на застапување на детето во постапката;</p>	<p>Се работи за техничка грешка бидејќи во Образложението на Решението за изрекување дисциплинска казна што го носи директорот, во ПРАВНАТА ПОУКА-стои дека против Решението детето има право на жалба во рок од 3 (три) дена од денот на добивањето на решението. Во моментот се работи на усогласување на сите подзаконски акти со Законот за изменување и дополнување на Законот за извршување на санкции, при што ќе биде коригирана техничката грешка.</p>

3	<p>Да се издаде наредба до сите вработени дека е строго забрането врз децата да се употребува каква било сила или средства за присилба надвор од законски предвидените услови, како и јасно истакнување на забраната децата да бидат удирани со шлаганици заради нивното поведење;</p>	<p>Сите вработени постапуваат согласно Законот за извршување на санкции и Правилникот за поблиските услови и начинот на употреба на средствата за присилба од страна на припадниците на затворската полиција во казнено-поправните и воспитно-поправните установи.</p>
4	<p>Да се води сметка дека секоја употреба на сила и средства за присилба, вклучително и средства за врзување (лисици) се заведува, и е предмет на оценка за оправданоста од таквата употреба;</p>	<p>Се постапува согласно Законот за извршување на санкции и Правилникот за поблиските услови и начинот на употреба на средствата за присилба од страна на припадниците на затворската полиција во казнено-поправните и воспитно-поправните установи.</p>
5	<p>Развивање протоколи за менаџирање на апстиненцијални кризи со соодветни лекови за тоа или доколку е потребно давање на супституциона терапија со Methadone или Buprenorphine;</p>	<p>Согласно Стандардните оперативни процедури за ефикасно обезбедување здравствена заштита во казнено-поправните и воспитно-поправните установи, Министерството за здравство обезбедува оптималното ниво на здравствена заштита за секое лице лишено од слобода, како и спроведување на принципот за обезбедување еднаква здравствена заштита во КПУ/ВПУ. Оттука, произлегува дека надлежни за организирање и спроведување на здравствената заштита во КПУ и ВПУ е Министерството за здравство, односно лекарите и здравствените работници кои ординираат во затворските, односно домските установи. Следствено, произлегува и заклучокот дека развивањето на протоколи за менаџирање на апстиненцијални кризи со соодветни лекови за тоа или доколку е потребно давање на супституциона терапија со Methadone или Buprenorphine е дел од активностите за Министерството за здравство. Постапување на протоколи за препишување на психофармаколошка терапија кај децата и електронско следење на медицинските дневници, пропишана терапија и следење на здравствената состојба, се прашања кои треба да се адресираат до надлежното министерство, Министерството за здравство.</p>

6	Лекувањето на децата со психотропни лекови да биде одобрено и со согласност на родител или законски старател.	Во однос на препораката лекарот да добие согласност од родителот или законскиот старател за лекување со психотропни лекови или доколку родителските права се прекинати, локацијата на родителот е непозната или пак, родителот/правниот старател одбива да се согласи, да се добие судско одобрение, ВПД Тетово има потреба од насоки како да постапи, од причина што целата медицинска документација, процедурите и резултатите од различни медицински испитувања се доверливи и можат да бидат видени само од здравствените работници.
---	---	--

ПСИХИЈАТРИСКА БОЛНИЦА ДЕМИР ХИСАР

Во декември 2025 година беше реализирана посета на Јавната здравствена установа – Психијатриска болница Демир Хисар. Целта на оваа посета беше да се испита состојбата со пациентите сместени во форензичко одделение на болницата, откако се добија информации за предизвикувачки состојби поврзани со т.н. проблематични пациенти. Во оваа смисла, беа извршени разговори со повеќе службени лица кои се дел од стручниот тим во болницата.

За време на разговорите беше истакнато дека форензичкото одделение на болницата се третира како место во кое завршуваат сите проблематични случаи со изречена мерка - безбедност од кривичните судови во Битола, Прилеп и Скопје. Токму поради спецификите и природата на случаите од една страна, а од друга страна немањето материјални и човечки ресурси, тимот одговорен за лекување и третман на пациентите е во неможност истите да ги изврши, но и да се справи со нив.

Тимот на НПМ доби наводи за случаи во коишто беа изразени сомнежи за професионализмот при одредени вештачења со кои, наместо правосилни затворски казни, лицата заради својата психичка состојба (наводна непресметливост) се упатуваат на форензичкото одделение во оваа болница. Токму овие случаи се и проблематичните за коишто персоналот нема соодветно решение и начин како да ги третира.

Имајќи предвид дека болницата ниту има соодветно обезбедување, ниту услови за задржување и грижа на ваков профил на лица, бегставата од нивна страна се доста честа појава, а во изминатиот период имало и случај на суицид.

Дел од персоналот со којшто беше разговарано манифестираше очиглени знаци на фрустрација, разочараност и прегореност. За ваквата состојба беше напоменато дека придонесува и фактот што болницата не располага со раководно лице (од 2024 година до денот на НПМ посетата биле сменети дури четири директори), па следствено нема кој да

ги издигне ваквите состојби на повисоко ниво, односно да се заеме за установата со цел доаѓање до решение.

Имајќи ја предвид ваквата состојба, како и наводите истакнати пред тимот на НПМ дека одредени лица „со помош на вешти лица“ и преку манипулативни активности успеваат да издејствуваат „поволно“ психијатриско вештачење, се отвора прашањето за сериозно отстапување од целта на кривичноправниот систем и суштинско поткопување на принципот на еднаквост пред законот и на правичноста на постапката. Наместо санкцијата да биде резултат на објективно утврдување на вината и одговорноста, таа станува производ на влијание врз експертската проценка.

Последиците од ваквата состојба непосредно се рефлектираат врз психијатриските установи (чија примарна функција е лекување и рехабилитација на лица со тешки психички нарушувања), па наместо установи со терапевтска, да се трансформираат во установи со доминантно безбедносна улога. **Присуството на лица кои немаат вистинска клиничка индикација за хоспитализација, туку се таму како резултат на „правна тактика“, ја менува институционалната култура и ја поткопува здравствената мисија.**

Дополнително, **ваквата состојба води кон ситуација каде што времето и вниманието на медицинскиот персонал се насочува кон лица кои не се вистински пациенти, додека лицата со реална и итна психијатриска потреба се соочуваат со подолги чекања, намалено внимание и влошени услови на лекување. На овој начин се повредува правото на здравствена заштита на најранливата категорија пациенти.**

Особено сериозни се последиците за другите пациенти – лицата со тешки психички нарушувања кои навистина имаат потреба од заштита и терапија. Присуството на лица кои не се пациенти во вистинска смисла, доведува до манипулација, виктимизација, заплашување и злоупотреба на останатите пациенти. Наместо безбедна и поддржувачка терапевтска средина, болницата се претвора во место на страв и доминација, што директно го нарушува процесот на лекување.

За персоналот во психијатриските установи, ваквата злоупотреба носи сериозни ризици. Лица со криминално искуство, антисоцијални однесувања и без вистински психопатолошки инхибиции претставуваат ризик фактор за насилство, заплашување и манипулација на севкупно присутните лица во установата. Медицинските техничари, психијатрите и другите здравствени работници кои се обучени за терапевтска работа, а не за управување со лица со изразен криминален профил, се изложени на зголемен професионален и личен ризик, манифестиран и преку непосредни и посредни закани.

Од аспект на превенција од тортура и нечовечко или понижувачко постапување, ваквата злоупотреба создава дополнителен ризик. Здравствената установа, која не е дизајнирана да функционира како казнено-поправна институција, импровизира примена на рестриктивни мерки без соодветна терапевтска оправданост, што доведува до повреди на правата и достоинството и на вистинските пациенти и на персоналот.

Со оглед на ова, тимот на НПМ се обрати и до Комората на вештаци, со барање информации во врска со примената на етичките и професионалните стандарди во судско-психијатриските вештачења.

Анекс 1: Надворешни соработници на Националниот превентивен механизам

1. д-р Силвана Марковска-Симоска, специјалист по детска и адолесцентна психијатрија,
2. Сашко Коцев, експерт од областа на полициското работење и миграциите и
3. Ребека Јачовска Трајковска, психолог.



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

**AVOKATI I POPULLIT
MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL**

RAPORTI VJETORË 2025

Shkup, 2026

PËRMBAJTA

1	AVOKATI I POPULLIT – MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL	63
2	AKTIVITETET DHE VIZITAT PARANDALUESE TË REALIZUARA NË VITIN 2025	65
3	VIZITA NË STACIONET POLICORE ME KOMPETENCË TË PËRGJITHSHME	67
	3.1 SP KP KARPOSH	67
	3.2 SP KP ÇAIR	69
	3.3 VIZITAT E NATËS NË SP KP TETOVË DHE SP KP GOSTIVAR	76
4	STACIONI POLICORË PËR MBIQYRJE KUFITARE SOPOT, STACIONI POLICORË PËR KONTROLL KUFITAR TABANOVÇË DHE QENDRA E PËRKOHSHME TRANZITE TABANOVÇË	73
5	INSTITUCIONET NDËSHKUESE - KORREKTUESE DHE EDUKUESEKORREKTUESE	79
	5.1 INSTITUCIONI NDËSHKUES KORREKTUES-BURGU KUMANOVË	79
	5.2 SHTËPIA NDËSHKUESE-PËRMIRËSUESE E LLOJIT TË HAPUR STRUGË	84
	5.3 ENTI NDËSHKUES PËRMIRËSUES BURGU I OHRIT	89
	5.4 ENTI NDËSHKUES-PËRMIRËSUES IDRIZOVË	94
	5.5 ENTI EDUKATIV-KORREKTUES TETOVË	95

6	SPITALI PSIKIATRIK DEMIR HISAR	105
	Shtojca 1: Bashkëpunëtorët e jashtëm të Mekanizmit Parandalues Nacional	107

Lista e shkurtesave

ARM	Armata e Republikës së Maqedonisë
EEK	Enti Edukues Korrektues
PP	Porkurori Publik
INK	Institucioni Ndëshkues Korrektues
ENK	Enti Ndëshkues Korrektues
MPB	Minsitria e Punëve të Brendshme
MD	Minsitria e Drejtësisë
AP	Avokati i Popullit
MPN	Mekanizmi Parandalues Nacional
AP- MPN	Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional
PTHP	Prokuroria Themelore Publike
SKNMSHR	Seksioni për Krim Ndërkufitar, Migracion, Shtetas të Huaj dhe Riatdhesim
QPT	Qendra e Përkohshme Tranzite
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
SPB	Spektori për Punë të Brendshme
DES	Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve
UNHCR	Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët

Të nderuar,

Mekanizmi Parandalues Nacional, mandati i të cilit rezultoi nga Protokollu Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese apo ndëshkuese, këtë vit shënon 15 vjet nga ekzistenca e tij.

Që nga formimi i Mekanizmit Kombëtar Parandalues në vitin 2011 e deri më sot, ekipi prej tre ekzekutuesve, emrat e të cilëve kanë ndryshuar ndër vite, ka kryer mbi 400 vizita në vendet e privimit nga liria në vend.

Megjithatë, edhe pse vitet pas nesh nuk duhen nënvlerësuar, as vizitat e kryera, duket se Mekanizmi Kombëtar Parandalues ende përballlet me vështirësi dhe sfida, si nga aspekti thelbësor, ashtu edhe nga ai organizativ. Kështu, ende vetëm tre persona e kryejnë këtë detyrë të përgjegjshme, ndërsa pamundësia për të angazhuar bashkëpunëtorë të jashtëm për të pestin vit me radhë, krijon shqetësime dhe probleme shtesë në realizimin e objektivave të caktuara.

Viti i kaluar ishte jashtëzakonisht i vështirë për shkak të gjendjes së përgjithshme në Institucionin e Avokatit të Popullit, gjë që u reflektua në vëllimin dhe dinamikën e punës së Mekanizmit Kombëtar Parandalues. Më konkretisht, për më shumë se gjashtë muaj institucioni funksionoi pa Avokat të Popullit të zgjedhur, gjë që ndikoi në realizimin e pandërprerë të mandatit, por edhe në pjesëmarrjen e ekipit të MPN në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rajonal. Mungesa e personit udhëheqës u reflektua edhe në pjesëmarrjen e aktiviteteve të rregullta në kuadër të rrjetit të MPN të Evropës Juglindore.

Megjithatë, pavarësisht kufizimeve të përmendura, gjatë vitit 2025 Ekipi i MPN realizoi gjithsej 13 vizita të pa paralajmëruara, dhe atë: 4 vizita në Stacionet Policore me Kompetencë të Përgjithshme, 5 vizita në Institucionet Ndëshkuese-Korrektuese dhe Edukativo-Korrektuese, 3 vizita në Qendrat ku strehohen dhe mbahen migrantët, shtetasit e huaj dhe azilkërkuesit (nga të cilat 2 në Stacionet Policore për Kontrollin e Kufirit, respektivisht Mbikëqyrjen), si dhe 1 vizitë në Institucion Psikiatrik.

Gjetjet nga vizitat e kryera, edhe këtë vit, tregojnë se gjendjet në terren dhe dobësitë sistematike me të cilat përballen personat e privuar nga liria mbeten sfida serioze për shtetin. Kështu, pavarësisht sugjerimeve të vazhdueshme, një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve ende nuk janë zbatuar plotësisht, për shkak të së cilës disa nga problemet kyçe përsëriten.

Për fund të kësaj pjesë, edhe një herë do të theksojmë nevojën për sigurimin e parakushteve institucionale të qëndrueshme për funksionimin e pandërprerë dhe efikas të Mekanizmit Parandalues Nacional, duke përfshirë edhe plotësimin e duhur të ekipit me kuadër përkatës. Këtu duhet të theksohet se ndryshe nga vitet e mëparshme, buxheti për vitin ak-



tual 2026 është dukshëm më i lartë se vitet e kaluara, por megjithatë mbetet të shqyrtohen mundësitë e vëna në dispozicion për shfrytëzimin e tij, veçanërisht ato në pjesën e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm.

AVOKAT I POPULLIT

Faton Selami

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Faton Selami', written in a cursive style.

AVOKATI I POPULLIT – MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL

Me miratimin e Ligjit për Ratifikimin e Protokollit Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese dhe Ndëshkuese¹, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më 30 dhjetor 2008 e caktoi Avokatin e Popullit të veprojë si Mekanizëm Parandalues Nacional.

Pas zbatimit të ndryshimeve të Ligjit për Avokatin e Popullit në vitin 2009, në kuadër të Avokatit të Popullit u formua njësi organizative e veçantë – Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN), detyra themelore e të cilit është parandalimi i torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese dhe ndëshkuese. Kompetencat e veta ekipi i MPN-së filloi t'i zbatojë në vitin 2011 përmes inspektimit të rregullt të trajtimit ndaj personave të privuar nga liria. Nga vizitat e kryera jepen rekomandime tek organet relevante, ndërsa kur është e nevojshme dërgohen edhe propozime dhe pasqyrime lidhur me legjislacionin ekzistues ose draft-ligjet.

Që nga formimi e deri më sot, ekipin e MPN-së e përbëjnë tre ekzekutues: një këshilltar shtetëror, një këshilltar dhe një bashkëpunëtor. **Prandaj, edhe një herë theksojmë se kjo përbërje dhe plotësim është i pamjaftueshëm për funksionim efikas, thelbësor dhe para së gjithash zbatimi me kohë i të gjitha kompetencave në përputhje me mandatin e këtij mekanizmi.**

Sfida kadrovike të ekipit të MPN janë edhe më të mëdha për shkak të problemit me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm nga profile të ndryshme, i cili vazhdon të ekzistojë.

¹ Ligji për Ratifikimin e Protokollit Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 165/2008) e qasur në: <https://dejure.mk/zakon/zakon-za-ratifikacija-na-fakultativniot-protokol-kon-konvencijata-protiv-tortura-i-drug-vid-na-surovo-nechovechno-ili-ponizhuvachko-postapuvanje-ili-k> (nga data 22.02.2024)

Ekipi është i detyruar të shpallë Prokurim Publik për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm përmes Sistemit Elektronik nga Byroja për Prokurime Publike, respektivisht përmes shpalljes së procedurës së tenderit. Gjatë vitit raportues, njësoj si në vitet e mëparshme, një prokurim i tillë publik nuk u realizua, me ç'rast në masë të madhe u pamundësua qasja në ekspertizën e duhur gjatë vizitave. **Prandaj, edhe një herë theksojmë se angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm përmes Prokurimit Publik, respektivisht tenderit, nuk përputhet me natyrën e mandatit që ky mekanizëm e ka.**

Në vitin 2025 AP-MPN vazhdoi bashkëpunimin me Zyrën e Komisionerit të Lartë për Refugjatë në Shkup (UNHCR), e cila përmes Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj e mbështeti Ekipin me sigurimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për nevojat e vizitave në terren në vendet e privimit nga liria të migrantëve, shtetasve të huaj dhe azilkërkuesit.

Përsëritja shumëvjeçare se Ekipit të MPN i nevojiten më shumë mjete për funksionim të pandërprerë, më në fund hasi në mirëkuptim tek autoritetet dhe si rrjedhojë buxheti i Ekipit të MPN për vitin 2026 u rrit shumëfish nga 211.000 denarë të ndarë në vitin 2025, në 955.000 denarë në vitin 2026.

Megjithatë, mbetet ende nevoja për rritjen e kapaciteteve kadrovike, për shkak të së cilës edhe një herë do ta përsërisim rekomandimin e dhënë nga Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës i Kombeve të Bashkuara (SPT) gjatë vizitës së tyre në vend në vitin 2017, kur në lidhje me plotësimin kadrovik, si dhe pavarësinë e Ekipit të MPN, Nënkomiteti rekomandoi:

„Nënkomiteti rekomandon që Mekanizmi Parandalues Nacional të konsultohet drejtpërdrejt me autoritetet e shtetit – anëtar për identifikimin e qartë të natyrës dhe përmasës së nevojave të tij, duke përfshirë edhe sigurimin e kontrollit mbi plotësimin kadrovik të tij”³.

² Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj ishte përgjegjëse për realizimin e buxhetit të ndarë për AP-MPN

³ Visit to the former Yugoslav Republic of Macedonia undertaken from 23 to 29 April 2017: observations and recommendations addressed to the national preventive mechanism, Subcommittee on Prevention of Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment, Optional Protocol to the Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment, e qasur në:<https://atlas-of-torture.org/en/entity/uyf8xx87py?page=1> (që nga: 25.02.2025)

AKTIVITETET DHE VIZITAT PARANDALUESE TË REALIZUARA NË VITIN 2025

Në vitin 2025 ekipi i MKP-së realizoi gjithsej 13 vizita të pa paralajmëruara, dhe atë: 4 vizita në Stacionet Policore me Kompetencë të Përgjithshme, 5 vizita në Institucionet Ndëshkuese-Korrektuese dhe Edukativo-Korrektuese, 3 vizita në Qendrat ku strehohen dhe mbahen migrantët, shtetas të huajt dhe azilkërkuesit (nga të cilat 2 në Stacionet Policore për Kontrollin e Kufirit, respektivisht Mbikëqyrjen), si dhe 1 vizitë në Institucion Psikiatrik.

Një pjesë e madhe e vizitave të realizuara parandaluese u kryen vetëm nga Ekipi i MPN-së. Për një numër të vogël vizitash (vendet për mbajtjen e migrantëve, shtetasve të huajt dhe azilkërkuesit) Ekipi angazhoi një bashkëpunëtor të jashtëm të siguruar përmes Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj, në kuadër të projektit me UNHCR-in të dedikuar për mbështetjen e MPN-së në lidhje me vendet për mbajtjen e migrantëve, shetasve të huajve dhe azilkërkuesve.

Metodologjia e punës bazohet në rekomandimet e organizatave dhe trupave ndërkombëtare relevante, dhe para së gjithash në Nënkomitetin për Parandalimin e Torturës pranë OKB-së.

Në planin ndërkombëtar, viti që kaloi ishte jashtëzakonisht pasiv. Respektivisht, përveç mundësive të kufizuara financiare, një pengesë shtesë ishte edhe vendi i zbrazët i Avokatit të Popullit në gjysmën e dytë të vitit, dhe si rrjedhojë pamundësia për të lëshuar Urdhërsa për udhëtime zyrtare.

Në kuadër të projektit "*Sundimi i ligjit në RMV*", AP-MPN, me mbështetjen e ekipit të projektit, organizoi për herë të dytë punëtori njëditore për udhëheqësit e turneve në rajonin e SPB Kumanovë. Punëtorja trajtoi çështjen e identifikimit dhe dokumentimit të shenjave të torturës, si dhe realizimin dhe sigurimin e të drejtës për mjek për personat e ndaluar në stacionet policore. Si ekspertë u angazhuan dr. Gjorgje Alempijeviq nga Republika e Serbisë dhe ekspertja nacionale, dr. Zháklina Prosaroska. Një punëtori e ngjashme, por për një rajon tjetër të SPB-së, do të

mbahet edhe gjatë vitit 2026.

Duke marrë parasysh gjithçka të përmendur më sipër, **edhe një herë theksojmë se Mekanizmi Parandalues Nacional ka mundësi të kufizuara, përkatësisht të pamjaftueshme kadrovike për zbatimin e plotë, efektiv dhe efikas të mandatit të tij të përcaktuar në përputhje me aktin ndërkombëtar të nënshkruar dhe të ratifikuar. Pikërisht për këtë arsye, shteti duhet në mënyrë konsekuente të zbatojë obligimet që dalin nga Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës⁵ dhe, në përputhje me të njëjtin, të sigurojë mjaftueshëm resurse për zbatimin efikas të mandatit të Mekanizmit Parandalues Nacional.**

⁴ Ligji për Ratifikimin e Protokollit Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese OPKAT (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 165/2008 e datës 30.12.2008)

⁵ Ibid

VIZITA NË STACIONET POLICORE ME KOMPETENCË TË PËRGJITHSHME

3.1 SP KP KARPOSH

Stacioni Policor Karposh është Stacion Policor me Kompetencë të Përgjithshme pranë Sektorit për Punë të Brendshme – Shkup (SPB Shkup), ndërsa kompetenca lokale për kryerjen e punëve policore e përfshin territorin e Komunës Karposh.

Edhe pse territori që ky stacion policor e mbulon ka rreth 80.000 banorë, **numri i përgjithshëm i zyrtarëve policorë të uniformuar (NPU) të punësuar në këtë stacion policor është i pamjaftueshëm, madje edhe shqetësues, pasi në kohën e vizitës nuk ishin të plotësuar as gjysma e vendeve të sistematizuara të punës.**

Një sfidë shtesë paraqet edhe largimi i kuadrit nga SP Karposh – vetëm në 5 muajt e fundit para vizitës së Mekanizmit Parandalues Nacional kishin lënë punën 6 të ZPU.

Sa i përket kushteve materiale, Stacioni Policor Karposh disponon me dy haspira për strehimin e personave të ndaluar, të pajisura me shtrat metalik të fiksuar me dyshek dhe shtroja të papastra për fjetje, si dhe me dritare të vogla me grila metalike sigurie. Në njërën dhomë xhami i dritares ishte i thyer, ndërsa higjiena në të dyja dhomat ishte në nivel shumë të ulët, respektivisht të pakënaqshëm.

Edhe pse zyrtarët me të cilët u zhvilluan bisedat theksuan se hapsirat nuk përdoren dhe se zakonisht personat që duhet të ndalohen dërgohen në SP KP Kisella Vodë, megjithatë gjatë inspektimit të drejtpërdrejtë u konstatua se në njërën nga hapsirat kishte qëndruar një person në periudhën menjëherë para vizitës së MPN.

Stacioni Policor disponon edhe me dy hapsira për marrje në pyetje dhe bisedë me të thirrurit, përkatësisht të ndaluarit, personat e privuar nga liria ose të mbajturit. Hapsirat janë të pajisura me tavolina dhe karrige të fiksuar, kamera për video-mbikëqyrje, ndërsa në mënyrë të

dukshme janë të ekspozuara edhe të drejtat e të ndaluarve, respektivisht personave të privuar nga liria dhe të mbajtur. Megjithatë, **Stacioni Policorë nuk ka ende një hapsirë të veçantë për bisedë me fëmijë.**

Një vërejtje pozitive është se në hapsirën e udhëheqësit të turnit, ku zakonisht në fillim dërgohen të ndaluarit, personat e privuar nga liria ose të mbajturit, ishin të ekspozuara dukshëm të gjitha informacionet e nevojshme për të drejtat e tyre.

Stacioni Policor është nën video-mbikëqyrje, si brenda, ashtu edhe në oborrin e tij. Megjithatë, një pjesë e oborrit është e zënë nga shumë automjete të prishura dhe të konfiskuara, të cilat për shkak të procedurave ende të papërfunduara janë lënë aty, duke e shëm-tuar oborrin, por edhe reputacionin e vetë Stacionit Policor. Nga ana tjetër, parku i automjeteve të Stacionit Policor është në gjendje shumë të keqe, përkatësisht i pamjaftueshëm për zhvillimin e pandërprerë të aktiviteteve në terren, për shkak të së cilës zyrtarët policorë të uniformuar janë të detyruar të përballen me atë që u vihet në dispozicion.

Përveç kushteve modeste, respektivisht të pakënaqshme materiale-teknike, si dhe kadro-vike, zyrtarët policorë të uniformuar në këtë Stacion Policor u ankuan edhe se nuk kanë uni-forma, respektivisht se nuk janë pajisur me të reja për një periudhë të gjatë kohore.

Në pjesën e realizimit të të drejtave, u theksua se gjatë ndalimit të shtetasve të huaj siguro-het përkthyes përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila gjithashtu i mbulon shpenzimet e përkthimit. Listë e avokatëve në kohën e vizitës nuk kishte, edhe pse në të kaluarën ka ekzis-tuar. Një nga arsytet për mungesën e një liste të tillë është mosardhja e avokatëve, pasi shpen-zimet për shërbimet e tyre nuk mbulohen. Kur ka pasur nevojë, kanë ardhur avokatë për fëmijë, por edhe ata kanë theksuar se do t'i ndërpresin shërbimet e tyre për shkak të mosmbulimit të shpenzimeve për shërbimet e ofruara. Në mungesë të një hapsire për zhvillimin e bisedave me fëmijë, përdoren hapsirat e destinuar për të rritur.

Sa i përket bashkëpunimit me shërbimet e Ndihmës së Shpejtë, nuk kishte ankesa.

Gjatë vizitës u theksua edhe nevoja për më shumë trajnime për të punësuarit.

Regjistrat që mbahen për të ndaluarit, përkatësisht personat e privuar nga liria dhe të mbajturit, mbahen përgjithësisht në mënyrë të rregullt, ku mund të ndiqet rendi i veprimeve ndaj personave nga momenti i ndalimit ose privimit nga liria dhe mbajtjes, deri në lirimin e tyre ose dërgimin tek organi kompetent për veprime të mëtejme. Në procesverbalet për mbajtjen e personave që i mbajnë udhëheqësit e turnit regjistrohen të dhëna për gjendjen shëndetësore të personave të mbajtur, si dhe informacioni se ata janë udhëzuar për të drejtat e tyre.

Duke marrë parasysh gjendjen e konstatuar, ekipi i MPN-së deri te Stacionit Policor drejtoi rekomandime për:

- përshtatjen e një hapsire të veçantë për bisedë me fëmijë, në përputhje me Ligjin për Drejtësi për Fëmijët;
- ndërmarrjen e masave për të kryer të gjitha riparimet e nevojshme në hapsirat e mba-jtjes, si dhe përmirësimin urgjent të higjienës në hapsirat e mbajtjes, ndërsa eprorët në Stacionin Policor të vendosin sistem të kontrollit të rregullt mbi higjienën dhe pajisjet në hapsirat e mbajtjes, në përputhje me Procedurat Operative Standarde.

Deri te Ministria e Punëve të Brendshme u dërguan rekomandimet e mëposhtme:

- Të rritet numri i zyrtarëve policorë të uniformuar sipas nevojave të stacionit policor, deri në plotësimin e plotë të vendeve të sistematizuara të punës;

- Të futen trajnime të detyrueshme për çdo nëpunës policor, veçanërisht për të sapopunësuarit, si dhe gjatë transferimit ose dërgimit në një pozicion të ri pune sipas specifikave të të njëjtit;
- Informacionet lidhur me ndalimin e torturës duhet të përfshihen plotësisht në trajnimin e personelit për zbatimin e ligjit, respektivisht zyrtarëve publikë dhe personave të tjerë që mund të përfshihen në arrestimin, marrjen në pyetje ose trajtimin e çdo individi të ekspozuar ndaj ndonjë forme arrestimi, ndalimi ose burgimi;
- Të sigurohen mjete për rinovimin e hapsirave të mbajtjes që do të përmbushin standardet minimale të parashikuara për mbajtjen e personave;
- Të përshtatet dhe adaptohet një hapsirë e veçantë për bisedë me fëmijë, në përputhje me Ligjin për Drejtësi për Fëmijët;
- Të sigurohen automjete shtesë për kryerjen e rregullt dhe efikase të detyrave policore, veçanërisht të blihet një automjet ndërhyrës.

3.2 SP KP ÇAIR

Në dhjetor 2025, Ekipi i MPN-së realizoi vizitë në hapsirat e reja të SP KP Çair (Butel), të vendosura në një pjesë të ndërtesës së Shtëpisë për Fëmijë pa Prindër "25 Maj" Shkup. Respektivisht, me vendim të Qeverisë, një pjesë e kompleksit iu dha në përdorim Ministrisë së Punëve të Brendshme, me çka janë ndërhyrë aktivitete për rinovimin e hapësirave me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme për punën e Stacionit Policor.

Megjithatë, nga informatat e marra nga Komandanti i Stacionit Policor, kjo zgjidhje është e përkohshme, duke marrë parasysh se zgjidhje afatgjatë është parashikuar ndërtimi i Stacionit të ri Policor, së bashku me Stacion për Zjarrfiksit.

Gjatë vizitës u krye inspektim i hapësirave të Stacionit Policor, ku u konstatua se të njëjtat janë tërësisht dhe në mënyrë të përshtatshme të rinovuara, të pajisura me mobilje të reja dhe ofrojnë kushte të kënaqshme për punën e të punësuarve, edhe pse **nuk janë siguruar hapësira të veçanta për bisedë me personat e ndaluar, të arrestuar dhe të thirrur, as hapsirë e veçantë për marrjen në pyetje të fëmijëve. Stacioni policor nuk disponon as me hapësira për mbajtjen e personave.**

Në stacion nuk kryhen mbajtje 24-orëshe të personave, por vetëm ndalime të shkurtra gjatë privimit nga lira dhe ndalimit, deri në momentin e transferimit në stacione të tjera të policisë të përcaktuara për mbajtjen e personave. **Kjo praktikë, ndonëse një zgjidhje e përshtatshme, krijon rrezik për vazhdimësinë e garancive procedurale, regjistrimin e saktë të veprimeve dhe mbikëqyrjen efektive të trajtimit të personave të privuar nga liria.**

Pikërisht për këtë arsye, **kushtet hapsinore dhe organizative në stacionin policor janë me rëndësi të veçantë nga aspekti i respektimit të garancive themelore procedurale dhe mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria.**

Gjatë vizitës u konstatua se në hapsirat e udhëheqësit të turnit nuk janë ekspozuar udhëzimet për të drejtat e të ndaluarve dhe personave të privuar nga liria, gjë që mund të ndikojë

negativisht në informimin e plotë dhe me kohë të këtyre personave për të drejtat e tyre ligjore për fazën fillestare të veprimit policorë.

Në mënyrë shtesë, edhe pse tualetet janë rinovuar, ato nuk janë përshtatur plotësisht për përdorim nga të ndaluarit dhe personat e privuar nga liria. Respektivisht, u vunë re rreziqe sigurie për mundësi të ikjes, duke marrë parasysh se dritaret janë të pambrojtura dhe rrezikun e pranisë së pasqyrave të thyera, që mund të përdoren për vetëdëmtim. **Këto rrethana tregojnë nevojën për ndërhyrje shtesë për minimizimin e rreziqeve dhe sigurimin e një mjedisi të sigurt për personat që qëndrojnë përkohësisht në hapsirat e Stacionit Policor.**

Duke pasur parasysh karakterin e përkohshëm të zgjidhjes ekzistuese dhe paralajmërimet për ndërtimin e një objekti të ri, **gjatë planifikimit dhe projektimit të ardhshëm të stacionit të ri policor, duhet të parashikohen dhe të integrohen me kohë të gjitha standardet minimale për rregullimin hapësinor. Konkretisht, hapësira të qarta dhe të destinuara për biseda, marrje në pyetje, mbajtje të personave dhe trajtim të fëmijëve, si dhe elemente të përshtatshme të sigurisë dhe informimit, me qëllim të harmonizimit të plotë me legjislacionin nacional dhe standardet ndërkombëtare relevante për parandalimin e torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese apo ndëshkuese.**

3.2 VIZITAT E NATËS NË SP KP TETOVË DHE SP KP GOSTIVAR

Në periudhën para Vitit të Ri, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizita të pa paralajmëruara gjatë natës në SP KP Tetovë dhe SP KP Gostivar.

Qëllimi i këtyre vizitave ishte të përcaktohej gjendja faktike lidhur me ekzistencën e personave të ndaluar, të privuar nga liria ose të mbajtur, si dhe të kontrollohej nëse veprimet policore gjatë orëve të natës zhvillohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Orët e natës njihen si periudhë me rrezik të shtuar për parregullsi eventuale, duke pasur parasysh se pikërisht në këtë interval kohor shpesh kryhen privime nga liria, transferime dhe mbajtje të shkurtra, me mbikëqyrje të reduktuar dhe praninë e kufizuar të kuadrit udhëheqës.

Realizimi i këtij lloji vizitash e manifeston rolin parandalues të Mekanizmit Parandalues Nacional, duke dërguar një mesazh të qartë se veprimet e ve policore mund të jenë objekt monitorimi në çdo kohë, pa paralajmërim, përfshirë edhe gjatë natës.

Gjatë vizitave, Ekipi i MPN-së zhvilloi bisedë hyrëse me zyrtarët policorë të shërbimit në të dy stacionet policore, për të marrë informata mbi gjendjen aktuale në stacion dhe ekzistencën eventuale të personave të ndaluar, të mbajtur ose të privuar nga liria.

Në mënyrë plotësuese, u krye gjithashtu inspektim i librave dhe evidencave për ngjarjet ditore dhe për personat e ndaluar dhe të mbajtur.

Nga bisedat dhe inspektimi i dokumentacionit u konstatua se në momentin e vizitave nuk

kishte persona të ndaluar, të privuar nga liria ose të mbajtur, as në Stacionin Policorë Tetovë, as në Stacionin Policorë Gostivar.

Në këtë drejtim, nuk u konstatuan indikacione për veprime ndaj personave të privuar nga liria, as nevojë për intervista të mëtejme ose inspektim të hapsirave të mbajtjes, pasi të njëjtat nuk ishin në përdorim në momentin e vizitës.

STACIONI POLICORË PËR MBIKQYRJE KUFITARE SOPOT, STACIONI POLICORË PËR KONTROLL KUFITAR TABANOVÇË DHE QENDRA E PËRKOHSHME TRANZITE TABANOVÇË

4

Në kuadër të kompetencave të tij, Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional vazhdimisht monitoron veprimet e organeve kompetente në vendet ku kryhet ose mund të kryhet mbajtja, respektivisht kufizimi i lirisë së lëvizjes.

Në këtë drejtim, Ekipi i MPN-së gjatë vitit realizoi tre vizita të pa paralajmëruara, me qëllim që të përcaktohet gjendja faktike dhe të identifikohen ndryshimet eventuale krahasuar me vizitat e mëparshme. Vizitat u realizuan në Stacionin Policorë për Mbikëqyrje Kufitare Sopot, Qendrën e Përkohshme të Tranzitit Tabanovcë dhe Stacionin Policorë për Kontroll Kufitar Tabanovcë, ndërsa për këtë qëllim, nga Mekanizmi Parandalues Nacional u angazhua bashkëpunëtori i jashtëm Sashko Kocev, ekspert me përvojë të gjatë policore dhe me njohuri të rëndësishme në fushën e migracionit.

Ekipimi kadrovik i Stacioneve Policore është një faktorë kyç i cili ndikon ndaj rrezikut të veprimit të papërshtatshëm ndaj personave me liri të kufizuar. Ndaj këtij roli ka edhe profesionalizëm që duhet të ndërtohet përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe forcimit të kulturës për veprime humane dhe dinjitoze.

Gjatë vizitave u konstatua se Stacionet Policore për Kontroll dhe Mbikëqyrje Kufitare nuk janë të plotësuar kadrovikisht, gjë që ndikon negativisht në efikasitetin e kryerjes së detyrave dhe rrit rrezikun e trajtimit të papërshtatshëm. U vërejt fluktuacion i lartë i kuadrit, me shpërndarje të pozita për punë pa trajnim adekuat për punën kufitare.

Në Qendrën e Përkohshme të Tranzitit Tabanovcë numri i zyrtarëve policorë në çdo turn është i pamjaftueshëm për detyrat e pranimit të migrantëve, ruajtjes së rendit publik dhe kontrollit të hyrje-daljeve. Detyrimet nga ana tjetër, tek pjesa e mbikqyrjes kufitare, në mënyrë plotësuese e rëndojnë punën e tyre.

Në qendër është siguruar pjesëmarrja edhe e përfaqësuesve nga institucione dhe organizata, duke përfshirë Minsitrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Kryqin e Kuq, si dhe Organizata

tjera Ndërkombëtare dhe Joqeveritare, që ofrojnë mbështetje në pjesën e strehimit dhe kujdesit të migrantëve.

Tek pjesa e kushteve materiale dhe teknike nuk u vunë re përmirësime të mëdha krahasuar me vizitat e mëparshme. Asnjë Stacion Policor nuk posedon hapsira të posaçme për mbajtje ose biseda me persona, gjë që është garanci e rëndësishme kundër trajtimit të papërshtatshëm. Për këtë, personat shpesh vendosen në hapsira zyrtare të zakonshme të papërshtatshme për këtë qëllim, nën mbikëqyrje të vazhdueshme të zyrtarëve policor. Këto rrethana në mënyrë shtesë rëndojnë vëllimin e punës të kuadrit të pakët po dhe ndikon në kryerjen e punëve tjera ditore.

Në mënyrë shtesë, u konstatua mungesë e pajisjeve funksionale teknike dhe materiale. Edhe pse një pjesë e pajisjeve formalisht ekzistojnë, të njëjtat nuk funksionojnë ose nuk përdoren sistematikisht ose nuk ka procedura të qarta për përdorimin e tyre. Kjo krijon rrezik për efikasitetin dhe për prishjen e të drejtës së privatësisë. Mungojnë edhe pajisje që ndikojnë ndaj efikasitetit të mbikëqyrjes kufitare, që kërkon mjete bashkëkohore teknike dhe kuadër të trajnuar përkatës për shfrytëzimin e tyre.

Gjithashtu, u evidentua mungesë e automjeteve zyrtare funksionale, uniformave, pajisjeve mbrojtëse dhe mjeteve bazë për punë. Këto situata ndikojnë negativisht në sigurinë dhe efikasitetin e zyrtarëve policorë.

Nga kjo, **gjendjet e konstatuara tregojnë për mungesë të kuadrit të mjaftueshëm, kushte jo të përshtatshme dhe pajisje teknike të pamjaftueshme.** Këto mangësi e ulin efikasitetin e mbikëqyrjes kufitare dhe tregojnë për dobësi në menaxhimin e resurseve materiale-teknike, gjë që ndikon negativisht në efikasitetin e përgjithshëm të punës dhe paraqet rrezik për respektimin e të drejtave të personave me liri të kufizuar të lëvizjes.

Trajtimi i personave të cilëve u është kufizuar liria e lëvizjes paraqet tregues kyç për respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit. Në këtë kontekst, veçanërisht e rëndësishme është siguri i garancive themelore procedurale, siç janë e drejta për informim në gjuhën që personi e kupton, e drejta për qasje te avokati, e drejta për ndihmë mjekësore dhe e drejta për të njoftuar një person të tretë për ndalimin. Këto të drejta paraqesin mekanizma themelorë për mbrojtje nga abuzimet dhe garantimin e një procedure të drejtë dhe ligjore.

E drejta për qasje te Avokati – E drejta për qasje te Avokati paraqet garanci themelore kundër torturës dhe trajtimit joadekuat. Megjithatë, në evidencat e Stacioneve Policore nuk janë shënuar raste ku personat e ndaluar me të vërtetë kanë kërkuar Avokat, as nuk është siguruar listë e Avokatëve kujdestarë që e njëjta duhet t'u ofrohet, siç është paraparë në nenin 161 të LPP. Kjo gjendje është në kundërshtim me Parimin 17 dhe 18 të UN Body of Principles (1988) dhe me standardet e CPT (CPT/Inf (2011) 28-part1, pikat 18–25), të cilat kërkojnë që qasja te avokati të mundësohet nga momenti i parë i privimit nga liria, në kushte të konfidencialitetit dhe pa përgjim.

E drejta për mjek – E drejta për kontroll mjekësor dhe mbrojtje shëndetësore paraqet garanci të rëndësishme për mbrojtjen e integritetit fizik dhe psikik të personave. Edhe pse në evidencat thuhet se shumica e personave nuk kanë kërkuar ndihmë mjekësore, nuk ka prova të mjaftueshme se ata janë informuar në mënyrë të duhur për këtë të drejtë, as se u është ofruar kontroll mjekësor në kushte privatësie. Kjo është në kundërshtim me Parimin 24 të UN Body of Principles (1988) dhe me rekomandimet e CPT (CPT/Inf (2002) 15-part, pika 42), sipas të cilave kontrollet duhet të kryhen pa praninë e policisë, përveç nëse ekziston arsye objektive sigurie.

E drejta për të njoftuar një person të tretë për ndalimin – Në evidencat pothuajse nuk ka

raste të shënuara ku personat e ndaluar kanë shfrytëzuar mundësinë për të njoftuar një person të tretë për ndalimin ose privimin nga liria. Ky informacion jep bazë për dyshim se e drejta nuk zbatohet në praktikë, edhe pse paraqet garanci themelore e përcaktuar me nenin 159 të LPP dhe Parimin 16 të UN Body of Principles (1988). Moslejimi ose mospraktikimi i kësaj të drejte paraqet rrezik nga izolimi i personave dhe trajtimi joadekuat eventual.

Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë vizitës nuk gjeti persona të ndaluar, përkatësisht persona të privuar nga liria ose të mbajtur në Stacionet policore të vizituara, por realizoi shqyrtim në evidencat dhe dosjet e veçanta që mbahen në të dy Stacionet Policore (evidencat për veprimet e zyrtarëve policorë në QPT Tabanovc janë pjesë e SP për MK Sopot).

Nga inspektimi i **Librave të evidencës së ngjarjeve ditore** u konstatua se ngjarjet në të dy Stacionet Policore regjistroheshin në mënyrë kronologjike, ndërsa të dhënat e përmbytura në këtë evidencë përputhen me të dhënat e përmbytura në evidencat e tjera.

Nga inspektimet e **Evidencës për personat e ndaluar** në SP MK Sopot, u konstatua se gjatë vitit 2025, deri në ditën e vizitës, ishte ndaluar vetëm një person i rritur mashkull nga Somalia, i cili brenda 6 orëve ishte dërguar për procedim të mëtejshëm në SP KP Kumanovë. Për këtë person është shënuar se ishte udhëzuar për të drejtat e tij, si dhe se nuk kishte nevojë për ndihmë mjekësore, as kishte kërkuar të shfrytëzonte të drejtën për Avokat ose ndihmë mjekësore. Në Evidencën për personat e ndaluar në SP KK Tabanovc u konstatua se gjatë vitit 2025, deri në ditën e vizitës, ishin ndaluar gjithsej 39 persona, të gjithë të rritur dhe shumica shtetas të huaj. Në evidencë është shënuar se të gjithë personat ishin udhëzuar për të drejtat e tyre, megjithëse mbetet diskutabile mënyra se si është bërë kjo me shtetasit e huaj që flasin të ashtu quajtura gjuhë të rralla. Për asnjë nga personat nuk ishte shënuar se kishin njoftuar një person të tretë për ndalimin e tyre, as se kishin kërkuar avokat ose u ishte ofruar ndihmë mjekësore. Ashtu si në SP MK Sopot, edhe në këtë Stacion Policor personat nuk mbahen më shumë se 6 orë dhe në shumicën e rasteve u Jjanë dorëzuar zyrtarëve policorë të SP KP Kumanovë për procedim të mëtejshëm dhe ndalim eventual.

Në **Evidencën për personat e privuar nga liria dhe të ndaluar**, deri në ditën e vizitës, në SP MK Sopot ishin regjistruar gjithsej 4 raste të privimit nga liria, të gjithë shtetas vendas, të cilët më pas ishin dërguar në SP KP Kumanovë dhe dorëzuar të udhëheqësi i turnit për procedim të mëtejshëm dhe ndalim. Vetëm për një nga personat është shënuar se kishte njoftuar një person të tretë (nënë) për privimin nga liria, ndërsa asnjë person nuk kishte kërkuar Avokat, as kishte nevojë për ndihmë mjekësore. Në SP KK Tabanovc, në Evidencën për personat e privuar nga liria dhe të ndaluar, janë shënuar 44 raste dhe, ngjashëm me procedimin e personave të ndaluar në këtë Stacion Policor, për asnjë person nuk është regjistruar se kishte njoftuar një person të tretë për ndalimin e tij, as se kishte kërkuar avokat ose ndihmë mjekësore. Edhe në këto raste, zakonisht personat e privuar nga liria u janë dorëzuar zyrtarëve policorë (kryesisht nga SP KP Kumanovë) për procedim të mëtejshëm.

Në **Evidencën për përdorimin e mjeteve të detyrimit** në SP MK Sopot, deri në ditën e vizitës, ishin regjistruar gjithsej 6 raste, nga të cilat në tre raste ishin përdorur mjete për lidhje – pranga, në një rast ishte përdorur forcë fizike dhe në dy raste të tjera ishin përdorur të ashtuquajturit “stingerë” për ndalimin e automjeteve. Në evidencë, në pjesën për pasojat e shaktuara, ishte shënuar vetëm “shpim i një gome” në të dy rastet kur ishin përdorur stingerët. Për përdorimin e mjeteve të detyrimit ishin përgatitur raporte përkatëse, ndërsa në librin e evidencës ishte shënuar se në të gjitha rastet përdorimi i mjeteve të detyrimit ishte i arsyetuar,

megjithëse nuk ishin dhënë dokumente të veçanta (nuk u dhanë për inspektim) nga të cilat rezulton se ishte bërë vlerësim i duhur për përdorimin e mjeteve të detyrimit. Në SP MK Tabanovc ishte regjistruar një rast i përdorimit të forcës dhe mjeteve të detyrimit (levë në dorën e majtë) dhe për të ishte përgatitur raport përkatës për forcën e përdorur, si dhe vlerësim për arsyetimin e forcës së përdorur, i vlerësuar si i arsyetuar nga eprori më i lartë, përkatësisht komandanti i Stacionit Policor.

Nga inspektimi i realizuar në dosjet individuale që mbahen për personat e ndaluar, përkatësisht personat e privuar nga liria dhe të mbajtur në të dy Stacionet Policore, u konstatua se ato udhëhiqen në mënyrë të rregullt dhe mund të ndiqet rendi i procedimit me personat nga momenti i ndalimit ose privimit nga liria dhe mbajtjes, deri në lirimin e tyre ose dërgimin e mëtejshëm për ndalim në SP KP Kumanovë.

Për çdo ndalim, përkatësisht privim nga liria, ekziston shënim zyrtar nga zyrtarët policorë që e kanë kryer ndalimin, përkatësisht privimin nga liria, si dhe konfirmime përkatëse për dorëzimin e personave të ndaluar/ të privuar nga liria, nga ku mund të ndiqet procedimi me këta persona nga ana e të gjithë personave zyrtarë me të cilët kanë qenë në kontakt.

Tabela nr.1

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIIN E GJENDJEVE TË KONSTATU- ARA dërguar deri te Ministria e Punëve të Brendshme dhe Byroja për Siguri Publike		
Nr. ren- dor.	Rekomandimi:	Përgjigja:
1	Plotësimi i të gjitha vendeve të parashikuara të punës në SP për MK Sopot dhe SP për KK Tabanovc, me qëllim realizimin efektiv të mbikëqyrjes kufitare dhe kontroleve kufitare.	<p>Nga ana e Byrosë për Siguri Publike – Departamenti për Punë Kufitare dhe Migracion është marrë përgjigja e mëposhtme: Ju njoftojmë se rekomandimet e dhëna janë shqyrtuar nga Departamenti për Punë Kufitare dhe Migracion. Ministria e Punëve të Brendshme është në procedurë të riorganizimit, gjatë së cilës rekomandimet do të merren parasysh dhe do të ndërmerren masa dhe aktivitete përkatëse me qëllim tejkalimin e gjendjeve të konstatuara.</p>
2	Vendosja e trajnimeve të rregullta për të drejtat e njeriut, trajtimin e kategorive të cenushme dhe parandalimin e torturës.	
3	Sigurimi dhe mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve teknike funksionale për mbikëqyrje kufitare (kamera, dronë, automjete me transmetim të pamjes), me procedura standarde të përcaktuara SOP dhe evidenca për përdorimin e tyre.	
4	Riparimi dhe furnizimi me automjete zyrtare për nevojat e stacioneve policore kufitare.	
5	Sigurimi i hapësirave të veçanta dhe të pajisura në mënyrë të përshtatshme për ndalim, me kushte për privatësi, siguri dhe qasje në ambiente sanitare, në përputhje me standardet ndërkombëtare.	
6	Vendosja e një sistemi për sigurimin e rregullt të ushqimit për personat e ndaluar, me intervale të qarta, vlerë ushqyese dhe mundësi për përshtatje sipas kërkesave fetare dhe shëndetësore.	
7	Sigurimi i një liste të avokatëve kujdestarë në të gjitha stacionet policore, e cila të jetë e disponueshme në gjuhën që e kupton personi i ndaluar.	
8	Sigurimi i kushteve për takime konfidenciale me avokatin dhe kontrole mjekësore në privatësi, pa praninë e policisë, përveç në raste të jashtëzakonshme.	
9	Vendosja e një mekanizmi për kontroll dhe auditim të rregullt të të gjitha evidencave për personat e ndaluar dhe përdorimin e mjeteve të detyrimit.	

INSTITUCIONET NDËSHKUESE -KORREKTUESE DHE EDUKUESE- KORREKTUESE

5.1 INSTITUCIONI NDËSHKUES KORREKTUES-BURGU KUMANOVË

Qëllimi i vizitës së pa paralajmëruar në INK Burgu Kumanovë ishte shqyrtimi i trajtimit ndaj personave të privuar nga liria, me fokus tek ata ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit dhe vlerësimi i shëndetit të tyre mendor dhe mirëqenies, Për çka, ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional angazhoi psikologen Rebeka Jačovska Trajkovska.

Në momentin e vizitës në institucion ishin të strehuar 130 persona të dënuar dhe 52 të paraburgosur, prej të cilëve një grua. Kapaciteti i parashikuar i institucionit është për 176 të dënuar dhe 54 të paraburgosur, por numri aktual i të paraburgosurve krahasuar me kushtet, veçanërisht sfida me furnizimin me ujë, tregon për mbipopullim dhe kapacitete joadekuate për strehim.

Morrëm informacion se një pjesë e madhe e personave të paraburgosur (rreth 20) janë dërguar për të vuajtur masën e paraburgimit në këtë burg nga Gjykata Penale Shkup, edhe pse sipas "Aktvendimit për shpërndarjen e të dënuarve dhe fëmijëve në Institucionet Ndëshkuese-Korrektuese dhe Edukative-Korrektuese, si dhe të paraburgosurve në repartet e paraburgimit të institucioneve ndëshkuese-korrektuese"⁶ në Burgun e Kumanovës në repartin e paraburgimit është parashikuar të strehohen persona meshkuj dhe femra ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit nga gjykatat e rajoneve: Berovë, Vinicë, Dellçevë, Koçan, Kratovë, Kriva Pallankë, Kumanovë, Radovish, Sveti Nikollë, Strumicë dhe Shtip.

Kjo mënyrë e dërgimit të personave në paraburgim paraqet një sfidë serioze që i shteron

⁶Miraturar nga Ministria e Drejtësisë dhe e shpallur në "Gazetën Zyrtare të RMV" 10/2020

kapacitetet e Burgut të Kumanovës, si nga aspekti material, ashtu edhe nga aspekti kadrovik (rritje e volumit të aktiviteteve të lidhura me monitorimin e drejtpërdrejtë, shoqërimet dhe të ngjashme). **Pikërisht për këtë arsye, është e domosdoshme që Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, në komunikim dhe koordinim me Gjykatat Themelore, të tregojë nevojën për respektimin e plotë të akteve nënligjore që rregullojnë dërgimin e personave në paraburgim,** si dhe të punojë për krijimin e kapaciteteve të përshtatshme me qëllim të tejkalimit të mbipopullimit në Institucionet Ndëshkuese Korrektuese, e jo vetëm transferimin e sfidave të lidhura me akomodimin e të paraburgosurve/të dënuarve nga një institucion në tjetrin, pa gjetur një zgjidhje sistemike.

Bazuar në gjendjen e konstatuar gjatë vizitave, ekipi i MPN konstatoi se në pjesën e strehimit në repartin e paraburgimit nuk janë respektuar dispozitat e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve, ku është parashikuar që për çdo person të dënuar duhet të sigurohen të paktën $9m^3/4m^2$ hapësirë⁷, si dhe minimumi i standardeve ndërkombëtare të parashikuara për strehimin e personave në institucionet e burgut⁸.

Gjatë inspektimit, në disa dhoma paraburgimi u gjetën dyshekë të vendosur në tokë me shtroje, mbi të cilët flinin personat e paraburgosur. U shpjegua se kjo gjendje është pasojë e aktiviteteve aktuale për renovimin e dhomave të paraburgimit, për shkak të të cilave një nga dhomat duhet të jetë gjithmonë bosh, ndërsa në një tjetër është strehuar vetëm një grua, në përputhje me rregullat për strehimin e grave.

Duke pasur parasysh se **Rregullat Evropiane për Burgjet** theksojnë qartë se “shtrati i veçantë” nënkupton **shtrat me kornizë**, dyshek dhe shtroje për çdo të burgosur⁹, fjetja mbi dyshek në tokë (pa kornizë shtrati) nuk i plotëson kushtet minimale sipas standardeve ndërkombëtare për dinjitetin, shëndetin dhe higjienën e personave të dënuar/të paraburgosur. Në këtë kuptim, ekipi i MPN rekomandoi që të bëhen përpjekje urgjente për të siguruar kushte të përshtatshme strehimi për çdo person të paraburgosur/të dënuar në përputhje me standardet e parashikuara.

Gjatë vizitës u vu re përsëri problemi i kahmotshëm me ujin e pijshëm. Institucioni disponon me sasi të caktuara uji teknik të siguruar nga puseta, por i njëjti është i pamjaftueshëm dhe jo i qëndrueshëm. Për këtë gjendje ankohen veçanërisht të dënuarit dhe të paraburgosurit, të cilët frikësohen si për higjienën e tyre, ashtu edhe për shëndetin. Në bisedë me disa nga të paraburgosurit u ndanë informacione se tek disa prej tyre është shfaqur zgjebja. Njëkohësisht, disa prej tyre theksuan se bëjnë përpjekje serioze për të përdorur në mënyrë racionale ujin që u shpërndahet nga zyrtarët, ndërsa disa përmendën se hanë më pak, sepse kanë sasi të kufizuara uji me të cilin duhet të ruajnë higjienën në tualetet që janë pjesë e hapsirave të paraburgimit.

⁷ Neni 157, paragrafi 1 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve “gazeta Zyrtare e RMV” nr. 99/19, 220/19, 236/22 dhe 74/24)

⁸ **The CPT’s minimum standard for personal living space in prison establishments** (- $6m^2$ of living space for a single-occupancy cell+ sanitary facility, - $4m^2$ of living space per prisoner in a multiple-occupancy cell+ fully-partitioned sanitary facility)

⁹ Rregulli 21 nga Rec(2006)2-rev- Recommendation of the Committee of Ministers to member States **on the European Prison Rules** (Adopted by the Committee of Ministers on 11 January 2006, at the 952nd meeting of the Ministers’ Deputies and revised and amended by the Committee of Ministers on 1 July 2020 at the 1380th meeting of the Ministers’ Deputies)

Drejtoria e institucionit në momentin e vizitës informoi se terreni rreth institucionit po mbikqyret për të shqyrtuar mundësitë e furnizimit të rregullt dhe të pandërprerë me ujë, me shpresë se problemi do të zgjidhet së shpejti, por nuk u ndanë informacione dhe hapa më të saktë.

Në pjesën e hapsirave të paraburgimit, ekipi i MPN gjatë inspektimit të drejtpërdrejtë konstatoi se edhe në hapsirat e reja të renovuara nuk funksionojnë sistemet për thirrje dhe alarmim të zyrtarëve, për shkak të së cilës të paraburgosurit vazhdojnë të jenë të detyruar të trokasin në dyer dhe të shpresojnë se do të dëgjohen nga përfaqësues të policisë së burgut. Gjithashtu, u vu re dëmtim i instalimeve elektrike dhe i llambave të tavanit. Temperatura dhe lagështia në dhoma ishin brenda vlerave referuese, ndërsa drita natyrale sigurohej përmes dritareve që gjenden në çdo hapsirë paraburgimi. Për higjienën e dhomave janë të ngarkuar vetë të paraburgosurit, ndërsa sa i përket higjienës personale u theksua se të gjithë të paraburgosurve u mundësohet të lahen një herë në javë, gjë që u përmend si e pamjaftueshme, veçanërisht gjatë periudhës së verës.

Çdo aktivitet që do të nënkuptonte daljen nga hapsira e paraburgimit dhe kalimin kreativ/ produktiv të kohës për personat e paraburgosur, nuk ekziston. Për ta është parashikuar vetëm një shëtitje e shkurtër prej 15 deri në 20 minuta në ditë. Kufizimi i shëtitjeve nën minimumin e domosdoshëm të parashikuar është për shkak të kapaciteteve të kufizuara, në lidhje me dispozitat që parashikojnë kontakte të kufizuara mes personave të paraburgosur.

Ky fakt ndikon seriozisht në intensifikimin e privimit brenda institucioneve penitenciare të personat e paraburgosur, gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e tyre mendor. Standardet ndërkombëtare, në këtë drejtim, theksojnë nevojën *"që autoritetet e burgjeve të hartojnë dhe zbatojnë një regjim gjithëpërfshirës aktivitetesh jashtë qelive. Personat e paraburgosur (si dhe të burgosurit e dënuar) duhet të kenë mundësi të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës (pra tetë orë ose më shumë) jashtë qelive të tyre, të angazhuar në aktivitete me qëllim të caktuar dhe të larmishme (punë, mundësisht me vlerë profesionale¹⁰, oarsim, sport, rekreacion/ bashkëveprim social). Sa më i gjatë të jetë periudha e paraburgimit, aq më i larmishëm duhet të jetë regjimi. Të gjithë të burgosurve, pa përjashtim, duhet t'u ofrohet të paktën një orë ushtrime ditore në ambient të hapur ose në hapësira të përshtatshme."*¹¹

Sa i përket kujdesit shëndetësor për personat e privuar nga liria, me theks të paraburgosurit, ekipi u informua se në ent vazhdon të jetë rregullisht i pranishëm një teknik mjekësor me orar pune prej tetë orësh. Ai është personi përgjegjës që më së shpeshti kryen pranimin e personave të privuar nga liria dhe, rrjedhimisht, bën edhe skrinimin e parë shëndetësor.

Dy herë në javë në ent vjen mjek, një herë stomatologu dhe njëherë psikiatër. Informacioni i fundit në lidhje me stomatologun dhe psikiatrin nuk ishte vërtetuar gjatë bisedës me persona tjerë. Pikërisht, ekipi i MPN-së ishte informuar se stomatologu vjen dy herë në muaj, kurse psikiatri aspak nuk vjen.

Ajo që gjithmonë bie në sy gjatë mbikëqyrjes në vendet për privim nga liria, është informacioni se gjithmonë gjatë kontrollimit të personit të privuar nga liria zyrtarisht merr pjesë person

¹⁰ Megjithatë, duhet të shtohet se, sipas Rregullës nr.100.1 të Rregullave Evropiane të Burgjeve, "personave të privuarve të burgosur do t'u ofrohet mundësia që të punojnë, por nga ata nuk do të kërkohet të punojnë".

¹¹ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe Sjelljes Johumane dhe Degraduese apo Ndëshkuese (KPT), Fragment nga Raporti i 26-të i Përgjithshëm i KPT, i publikuar në vitin 2017.

zyrtar (i uniformuar). Praktika e këtillë zgjat më shumë kohë, prej këtu ekipi i MPN edhe njëherë thekson se **kontrollet shëndetësore nevojitet të realizohen pa mbikëqyrje na policia e burgut, përveç në raste të veçanta kur tekniku mjekësor do të vlerësojë se ka nevojë për atë**. Në të njëjtën kohë, ishin siguruar informacione se gjithmonë kontrolli fillestar realizohet në afat prej 24 orëve nga pranimi.

Në atë drejtim, ekipi i MPN-së rekomandon respektimin e dispozitave të "Rregullores së rendit shtëpiak për realizimin e masës së paraburgimit në repartet e paraburgimit të burgjeve" ku është paraparë se „**kontrolli mjekësor realizohet pa prezencën e pjesëtarit të policisë menjëherë, më së voni në afat prej 24 orëve prej pranimit të personit të paraburgosur.**”¹²

Ekipi i MPN gjatë kohës së vizitës konstatoi se edhe më tutje enti nuk lejon pranimin e personave të varur sepse nuk shpërndan terapi për ata (as metadonike, as buprenorfinë). Kur do të konstatohet se personi i sapopranuar është i varur, menjëherë kërkohet transformimi i saj në ent tjetër penitenciar.

Enti korrespondon me dy vetura transportuese, dy vetura të lehta, por të njëjtat nuk mjaftojnë për të përmbushur pa pengesa nevojat e entit. Në këtë pjesë, duhet të theksohet se vetura "më e re" është njëzet vjet e vjetër kjo flet mjaftueshëm për kapacitetin dhe mundësitë në lidhje me parkun e automjeteve të këtij enti penitenciarë.

Kur bëhet fjalë për plotësimin me personel kadrovik të burgut, edhe pse ekipi i MPN-së ishte i informuar se kapaciteti i plotëson 85% të vendeve të punës, megjithatë kur do të merret parasysh se rregullisht një numër i caktuar i zyrtarëve dërgohen në një burg tjetër për ndihmë, si dhe shfrytëzimi i rregullt i pushimeve vjetore, pushimeve mjekësore e të ngjashme, numri i kuadrit në dispozicion në raport me popullatën e të dënuarve dhe të paraburgosurve është i pamjaftueshëm. Punësime të reja në vitet e fundit nuk ka pasur. Mungesa e kuadrit në mënyrë ilustrative shpjegohet me shembullin se ndonjëherë në shoqërim dërgohen nga dy persona edhe atë në dy gjykata të ndryshme, ndërsa që të kthehen pas, personat duhet të priten.

Gjithashtu, patjetër të theksohet se policia e burgut nuk korrespondon me pajisje të re bashkëkohore për sigurim, si dhe mjete për detyrim. Për herë të fundit, uniforma kanë pranuar në vitin 2013, kur edhe është hapur ky burg.

Kur bëhet fjalë për aspektin e sigurisë, gjuajtjen e fundit policia e burgut e ka pasur më vitin 2024 me iniciativë të NJSSH. Në këtë kontekst, ishte theksuar se ushtrime të këtij lloji organizohen vetëm nëse ndonjëri (më shpesh policia) del në ndihmë.

Në lidhje me angazhimin në punë, ekipi i MPN-së ishte informuar se personat e dënuar janë të angazhuar me punë si në vet entin, ashtu edhe jashtë entit, varësisht nga trajtimi.

Gjatë kohës së bisedave të drejtpërdrejta me personat e paraburgosur nuk u pranuan ankesa për çfarëdolloj veprimi jo adekuat as nga udhëheqësia e entit, as edhe nga ana e policisë së burgut. Megjithatë, të gjithë ishin të njëzëshëm në lidhje me kushtet e qëndrimit, posaçërisht për mungesën e ujit dhe të mundësisë për mirëmbajtjen e higjienës në hapësirat, në të cilat qëndrojnë. Ankesa kishte në lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit në ambient të hapur, respektivisht "shëtitja" (momentalisht ndërmjet 15/20 minuta dhe gjysmë orë), si dhe për ushqimin.

¹² Neni 10 paragrafi (2) i Rregullores ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/20)

Gjatë bisedës me të paraburgosur u realizua edhe një lloj i vlerësimit psikologjik të gjendjes së tyre mentale dhe i stabilitetit. Gjatë së cilës ishit notuar më shumë rreziqe psikologjike dhe strukturale të cilat mundën të kenë efekt kumulativ ndaj gjendjes mentale të personave të paraburgosur:

- *Disfunktionalitet i ekipit multidisciplinar për parandalim të vetëvrasjeve* – edhe pse formalisht ekziston, ekipi nuk realizon takime të rregullta, nuk realizohet monitorim i rregullt i rasteve të rrezikshme dhe nuk vendos plane individuale për intervenim. Mungesa e këtij mekanizmi kyç e rrit rrezikun e paraqitjeve të krizave akute psikologjike si dhe sjelljeve suicidale;
- *Kapaciteti i pamjaftueshëm i personelit* – pjesa më e madhe e të punësuarve nuk kanë trajnim të specializuar në fushat si vlerësimi psikologjik, intervenim gjatë krizave, edukim psikik dhe teknika për deeskalim të konflikteve. Kjo rezulton me aftësi të kufizuara për njohjen e hershme të simptomave alarmante dhe veprime parandaluese;
- *Faktor Institucional Stresogjen* – kushtet restriktive, autonomia e kufizuar, ndryshimet e shpeshta të paparapara në orarin dhe mungesa e aktiviteteve adekuate për stimulim psikosocial të cilat rrisin nivelin e stresit kronik, e cila mund të sjellë deri te rritja e simptomave depresive, ankioze dhe posttraumatike.

Duke e pasur parasysh gjendjen e konstatuar deri te Burgu i Kumanovës janë drejtuar rekomandimet si në vijim:

1. Të bëhen përpjekje urgjente që të sigurohet krevat me kornizë, dyshek dhe çarçafë për secilin person të paraburgosur/dënuar, me qëllim shmangien e situatave ku personat e paraburgosur/të dënuar flejnë në dyshekë të shtrirë në tokë;
2. Të merren masa për sanimin dhe vëndosjen në funksion të sistemeve për thirrje dhe alarmim të personave zyrtar të cilat gjinden në hapësirat për paraburgim, zëvendësimi i instalimit elektrik të dëmtuar si dhe i ndriçimit në tavan;
3. Planifikimi i masave, me të cilat do të sigurohen kapacitete (kadrovike si dhe materiale) që të konceptohet dhe realizohet regjim i aktiviteteve jashtë hapësirave të personave të paraburgosur, me qëllim që personat të kalojnë një pjesë të konsiderueshme të ditës (d.m.th. tetë orë ose më shumë) jashtë qelive të tyre, të angazhuar në aktivitete të dobishme dhe të larmishme (punë, mundësisht me vlerë profesionale, arsimim, sport, rekreacion/shoqërim);
4. Kontrollat mjekësore të realizohen pa prezencën e përfaqësuesit të policisë së burgut, në afat prej 24 orëve nga pranimi i personit të paraburgosur;
5. Të realizohet vlerësim i nevojës për ndryshim të aktit të sistematizimit dhe të organizimit në pjesën e rritjes së numrit të patjetërsueshëm të përfaqësuesve të policisë së burgut;
6. Restartimi funksional i ekipit multidisciplinar – vendosja e orarit të rregullt të takimeve, vendosja e sistemit për vlerësim individual të rrezikut dhe integrimi i psikologëve, i punëtorëve socialë, i personelit mjekësor dhe i zyrtarëve të sigurisë;
7. Edukim i vazhdueshëm i specializuar i personelit – implementimi i trajnimeve për njohjen e shenjave të krizës psikologjike, rrezikut suicidiv dhe teknikave për ndihmën e parë urgjente;

8. Programeve strukturore për përkrahje psikologjike – sesione individuale dhe grupe psikoterapeutike, programe për zhvillimin e aftësive sociale dhe aktiviteteve për rehabilitim psikosocial;
9. Monitorim dhe evaluim – vendosja e sistemit për matjen e vazhdueshme të efektivitetit të intervenimeve dhe adaptimin e tyre mbi bazën e indikatorëve relevantë.

Deri te Drejtoria e Zbatimit të Sanksioneve ishin udhëzuar rekomandimet si në vijim:

1. Të sigurohen pajisje të reja dhe bashkëkohore për sigurimin si dhe mjete për detyrim;
2. Të plotësohen vendet e punës në pajtim me aktin e sistematizimit të vendeve të punës;
3. Të sigurohen automjete të reja dhe funksionale për shkak të përmbushjes së nevojave të entit;
4. Të gjindet zgjidhje e përhershme me furnizimin me ujë të burgut.

Drejtoria e Ekuekutimit të Sanksioneve rregullisht i notoi rekomandimet e dhëna nga ana e Mekanizmit Parandalues Nacional dhe konfirmoi se do të veprohet sipas të njëjtave. Pikërisht, që më vitin 2026 planifikohen punësime plotësuese si dhe avancime, kurse sa i përket ujit për pije, është gjetur zgjidhje e arsyeshme dhe rrjedhimisht asaj do të shpallet prokurim publik.

Mbetet që këto propozim-zgjidhje dhe niveli i zbatimit të tyre edhe më tutje të monitorohet nga ana e Mekanizmit Parandalues Nacional.

5.2 SHTËPIA NDËSHKUESE-PËRMIRËSUESE E LLOJIT TË HAPUR STRUGË

Në SHNP e llojit të hapur Strugë sipas dispozitave pozitive-juridike sistemohen:

a) persona të gjinisë mashkullore të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale të kryera nga pakujdesia, për të cilat është caktuar dënim me burg deri në tri vite nga Rajoni i Gjykatës Themelore Penale Shkup dhe të gjithë gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe

b) persona të gjinisë mashkullore – të paraburgosur, të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me dënim me burg deri në një vit për vepra penale të kryera nga pakujdesia të cilat janë kryer në kthim nga Rajoni i Gjykatës Themelore Penale Shkup si dhe të gjithë gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut¹³.

¹³ Vendim për sistemimin e personave të dënuar dhe të fëmijëve në shtëpitë ndëshkuese-korrektuese dhe edukativo-korrektuese, si dhe të personave të paraburgosur në repartet e paraburgimit të shtëpive ndëshkuese-korrektuese – Numri i Gazetës Zyrtare: 34/2025

Gjatë kohës së vizitës në SHNP Strugë kishte gjithsej 5 persona të dënuar (të gjithë me trajtim A), kurse 2 udhëhiqeshin se janë në arrati.

Numri i të punësuarve është më i vogël në krahasim me atë që është paraparë në sistematizim, gjithashtu nuk ka person të punësuar të gjinisë femërore. Duke e pasur parasysh numrin e vogël të të dënuarve, të cilët aktualisht janë në vuajtje të dënimit me burg, gjithashtu duke e pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për shtëpi të llojit të hapur, ishte theksuar se menaxhimi në pjesën e rendit dhe disiplinës realizohet pa sfida më serioze.

Mjetet buxhetore me të cilat korrespondon institucioni janë të pamjaftueshme, posaçërisht nëse merret parasysh se pjesa më e madhe harxhohet për fatura për energji elektrike, dhe në mënyrë plotësuese, ndahen mjete për barnat e nevojshme për personat e dënuar. Për këtë ishte theksuar se buxheti institucional nuk ka mundësi të mëdha për ndërmarrjen e aktiviteteve më të mëdha, të cilët do të përfshijnë rinovimin e kapaciteteve për vendosje.

Një pjesë e personave zyrtarë u ankuan se nuk kanë mjete adekuate, hapësirë, pajisje për punë si dhe materiale për realizimin e obligimeve të tyre me shkallë më të lartë profesionale, dhe si shembull ishin theksuar edhe mungesa e testeve bashkëkohore të certifikuara për testime psikologjike.

Në lidhje me mbrojtjen shëndetësore ishte theksuar se në intervalet e rregullta kohore vjen motër mjekësore, kurse më rrallë dhe sipas nevojës vjen edhe mjek. Kur rrethanat e imponojnë këtë, ftohet edhe ekip i Ndihmës së Parë Urgjente, kurse në numrin më të madh të rasteve edhe personat e dënuar, duke e pasur parasysh trajtimin të cilin e kanë, vetë organizohen dhe shkojnë pranë institucioneve shëndetësore kur kanë nevojë për atë.

Në pjesën e kapaciteteve vendosëse, ekipi i MPN-së konstatoi se hapësirat, në të cilat flenë të burgosurit, dallojnë në pjesën e pajisjeve dhe higjienës, varësisht kapaciteteve që kanë në dispozicion si dhe përkujdesjes, të cilën e ofrojnë personalisht të burgosurit, të cilët janë të vendosur në hapësirat përkatëse.

Si gjendje serioze shqetësuese mund të përshkruhet pjesa në tualetet dhe banjat e përbashkëta të cilat janë në gjendje të rëndë dhe hapet çështja, a mund të përdoren në mënyrë dinjitoze të njëjtat nga ana e të dënuarve.

Kuzhina dhe mensa janë të pajisura në mënyrë modeste me inventar të vjetër dhe të konsumuar, gjithashtu len përshtypje të keqe se është lënë pasdore dhe ambienti në të cilat ruhet një fond i caktuar bibliotekar me libra.

Shëtitoretja është e gjerë, por pa shumë mundësi për pushim në ambient të hapur gjatë kushteve jo të përshtatshme atmosferike, si dhe pa shumë pajisje sportive të parapara për sport dhe rekreacion.

Marrëdhëniet midis të punësuarve dhe personave të dënuar ishin korrekte dhe adekuate, njëjtë siç ishte theksuar se edhe marrëdhëniet midis personave të dënuar janë të mira dhe tolerantë midis veti. Në këtë drejtim, ishte theksuar se deri tani nuk ka pasur nevojë për përdorimin e forcës ose mjeteve për detyrim nga ana e policisë së burgut, kjo ishte notuar gjatë mbikëqyrjes së librave të evidencës.

Megjithatë, ekipi i MPN-së ishte informuar se më datë 28.04.2025, në institucion është realizuar aksion nga ana e Njësisë për Intervenime të Policisë së Burgut, gjatë së cilës janë realizuar bastisje personale si dhe bastisje në hapësirat e personave të burgosur. Në lidhje me realizimin e aksionit ishin pranuar një numër më i madh i ankesave për mënyrën e realizimit dhe

veprimet e ndërmarra edhe atë si në pjesën e respektimit të procedurave për realizim të basteve në hapësirat e personave të dënuar, njëjtë edhe në pjesën, gjoja, qëndrimin agresiv jo-profesional dhe të panevojshëm ndaj personave të dënuar. Pikërisht, ishin siguruar pretendime se të gjithë personat e dënuar janë nxjerrë në shëtitore dhe janë detyruar që një periudhë të gjatë kohore (rreth 2 orë) të qëndrojnë me këmbë dhe duar të hapura mbështetur për muri, pa mundësi që pastaj të ankohen që qëndrimi i atillë u ka shkaktuar probleme serioze shëndetësore (posaçërisht që një pjesë e personave të dënuar janë persona mbi moshën 60 vjeçare). Gjatë sqarimit të situatës konkrete ishte theksuar edhe se çdo orvatje për tu spostuar nga pozicioni i urdhëruar, kinse ishte përcjellë me komente të papërshtatshme nga ana e personave të uniformuar, madje edhe me goditje në këmbë, trup dhe në pjesën e pasme të qafës së personave të dënuar.

Duke i pasur parasysh pretendimet e këtilla, si dhe për shkak të sigurimit të më shumë të dhënave për aksionin e realizuar, me qëllim që të vërtetohet gjendja faktike, ekipi i MPN-së kërkoi nga Drejtoria e Ekzekutimit të Sanksioneve të dorëzohet Raporti i komandantit të NJIPB, në të cilin janë të përmbledhura aktivitetet dhe informacionet për aksionin e realizuar. Obligimi i këtillë buron nga Rregullorja për mënyrën e formimit dhe punën e Njesisë për Intervenime të Policisë së Burgut në Entet Ndëshkuese-Përmirësuese¹⁴, në pajtim me të cilën komandanti i NJIPB është i obliguar që pas çdo aksioni të përpilojë raport, të cilin e dorëzon deri te drejtori i DES (neni 8).

Nga ana e Drejtorisë së Ekzekutimit të Sanksioneve, përkatësisht ENP EPN Indrizovë Shkup ishte shpërndarë Informacioni zyrtar¹⁵ i përgatitur në lidhje me rastin e lartpërmendur. Në të njëjtin është potencuar aksioni i realizuar, bastisje e personave dhe hapësirave, data dhe kohëzgjatja e së njëjtës, numri i pjesëtarëve, të cilët kanë marrë pjesë si dhe automjetet të cilat janë përdorur si dhe numri i personave, të cilët kanë qenë cak i bastisjes, si dhe numri i hapësirave të bastisura. Në shënim, pastaj janë theksuar të gjitha sendet e gjetura të cilat janë të ndaluara, p.sh. celularë, tablet, kartëmonedha të huaja si dhe një qese me substancë të panjohur bimore. Pastaj, në të janë theksuar probleme gjatë realizimit të aksionit ose çfarëdolloj përdorimi të forcës.

Edhe pse informacioni i shpërndarë me ekipin e MPN-së nuk përmban ndonjë element për përdorimin e forcës, megjithatë Mekanizmi Parandalues Nacional udhëzon që të respektohen të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria dhe të vepruarit human me të njëjtit. Pikërisht, secila nevojë e realizimit të bastisjes së personave dhe të hapësirave duhet të realizohet në përputhje me protokolle dhe procedura të definuara me ligjshmërinë nacionale. Personat të cilët e realizojnë bastisjen duhet të jenë të trajnuar mirë që të mos shkaktojnë ndjesi frike ose nënvlerësimi të personi i dënuar. Më pastaj, Rregullorja për mënyrën e formimit dhe të punës së Njesisë për Intervenime të Policisë së burgut në Entet Ndëshkuese-Përmirësuese në mënyrë të qartë e precizon kur, ku dhe në cilën mënyrë kjo njësi vepron, dhe rrjedhimisht kësaj përdëftojmë që të zbatohet me përpikshmëri dispozita e këtillë ligjore, si dhe nevoja e organizimit dhe realizimit të trajnimeve të

¹⁴ Nr.02-1663/1 e datës 01.11.2024, e sjellë nga drejtori i DES

¹⁵ Informacion zyrtar, 04-2/707 i datës 29.04.2025, Drejtoria e Ekzekutimit të Sanksioneve, ENP-EPN Idrizovë, Shkup

rregullta për pjesëtarët e Njësisë me theks të veçantë në parandalimin e torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit tjetër çnjerëzor ose poshtëruës.

Edhe pse informacioni i shpërndarë me ekipin e MPN-së nuk përmban ndonjë element për përdorimin e forcës, megjithatë Mekanizmi Parandalues Nacional udhëzon që të respektohen të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria dhe të vepruarit human me të njëjtit. Pikërisht, secila nevojë e realizimit të bastisjes së personave dhe të hapësirave duhet të realizohet në përputhje me protokolle dhe procedura të definuara me ligjshmërinë nacionale. Personat të cilët e realizojnë bastisjen duhet të jenë të trajnuar mirë që të mos shkaktojnë ndjesi frike ose nënvlerësimi të personi i dënuar¹⁶. Më pastaj, Rregullorja për mënyrën e formimit dhe të punës së Njësisë për Intervenime të Policisë së burgut në Entet Ndëshkuese-Përmirësuese¹⁷ në mënyrë të qartë e precizon kur, ku dhe në cilën mënyrë kjo njësi vepron, dhe rrjedhimisht kësaj përdëftojmë që të zbatohet me përpikshmëri dispozita e këtillë ligjore, si dhe nevoja e organizimit dhe realizimit të trajnimeve të rregullta për pjesëtarët e Njësisë me theks të veçantë në parandalimin e torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit tjetër çnjerëzor ose poshtëruës.

Përskaj gjendjes së notuar më sipër, gjatë kohës së vizitës ishin siguruar informacione edhe në lidhje me transformimin e planifikuar të entit në objekt për sistemim të personave të gjinisë femërore të udhëzuara për vuajtje të dënimit me burg. Transformimi i këtillë nuk paraqet vetëm ridestininim administrativ ose hapësinor, por edhe përmbajtësor dhe sistematik. Rrjedhimisht, ky proces kërkon rishqyrtim të të gjithë konceptit të funksionimit të entit – në aspektin e infrastrukturës, të regjimit si dhe të profilit dhe të trajnimit të personelit.

Prandaj, paralajmërimet për transformim të SHNP Strugë në ent për vuajtjen e dënimit me burg nga ana e personave të gjinisë femërore ngrenë çështje serioze që kanë të bëjnë me përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare, posaçërisht me Rregullat e Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të burgosurve të gjinisë femërore (Bangkok Rules)¹⁸.

Pikërisht, gratë në mjedisin e burgut paraqesin kategori specifike dhe të cenueshme të personave të privuar nga liria, nevojat e të cilëve në masë të madhe dallojnë nga ato të të burgosurve të gjinisë mashkullore. Rregullat e Bangkokut, në mënyrë të qartë fillojnë nga fakti se pjesa më e madhe e të burosurve të gjinisë femërore kanë histori të dhunës familjare, seksuale ose të dhunës së bazuar në përkatësinë gjinore, varshmërive, traumave psikosociale si dhe përkujdesjes thelbësore për fëmijët dhe anëtarët tjerë të familjes. Prej këtui, ekipi i MPN-së theksoi se përgjigjja institucionale patjetër duhet të jetë e rregullt dhe senzitive, e individualizuar dhe me qëllim të mbrojtjes së dinjitetit, shëndetit dhe mirëqenies sociale të grave.

¹⁶ Recommendation Rec(2006)2 of the Committee of Ministers to member states on the European Prison Rules, Adopted by the Committee of Ministers on 11 January 2006 at the 952nd meeting of the Ministers' Deputies

¹⁷ Rregullorja për mënyrën e formimit dhe punës së Njësisë për Intervenime të Policisë së Burgut në SHNP, i qasshëm në: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2025/04/eizp.pdf>

¹⁸ Rregullat e KB për trajtimin e të burgosurve të gjinisë femërore dhe të masave jo të burgut, për gratë të cilat kanë kryer vepra penale, me komentime (Rregullat nga Bangkokui), i qasshëm në: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Bangkok_Rules_ENG_22032015.pdf

Një nga specifikat kyçe gjatë transformimit të këtillë ka të bëjë me kushtet infrastrukturore dhe hapësinore. Enti aktual, i cili ka qenë i dizajnuar dhe deri tani i shfrytëzuar ekskluzivisht për popullatën e gjinisë mashkullore nuk mund të thuhet se i merr parasysh nevojat në lidhje me privatësinë, higjienën dhe përkujdesjen shëndetësore të grave.

Rregullat e Bangkokut kërkojnë sigurimin e kushteve të përshtatshme sanitare, qasje të vazhdueshme deri te mjetet higjienike si dhe hapësira dhe kushte të veçanta për gratë shtatzëna, nënat mundesha dhe gratë me gjendje specifike shëndetësore. Këto kërkesa nënkuptojnë rikonstrukcion real dhe të thellë e jo përshtatje minimale.

Mbrojtja shëndetësore paraqet edhe një fushë kritike. Për dallim nga të burgosurit e gjinisë mashkullore, personat e burgosur të gjinisë femërore që kanë të bëjnë shëndetin reproduktiv, mbrojtjen gjinekologjike, periudhën e shtatzënisë si dhe asaj pas lindjes.

Rregullat e Bangkokut parashohin kontrolle të rregullta shëndetësore gjatë pranimit, përkujdesje të vazhdueshme gjinekologjike si dhe përkrahje psikologjike, posaçërisht për gratë të cilat kanë më herët kanë pësuar dhunë. Sistemi shëndetësor në ent patjetër të jetë i përgatitur në aspektin funksional për këto nevoja, dhe jo të mbështetet në zgjidhje ad-hok.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet masave të sigurisë dhe disiplinës. Përdorimi i forcës, bastisjes personale dhe sanksioneve disiplinore te gratë e burgosura mund të shkaktojnë ri-traumatizim, si dhe viktimizim sekondar nëse nuk zbatohen me kujdes të veçantë.

Rregullat e Bangkokut insistojnë që bastisjet personale të kryhen ekskluzivisht nga zyrtare femra dhe të shfrytëzohen metoda alternative për kontrolle aty ku është e mundur. Në mënyrë plotësuese, përkufizimet si izolim ose sanksionet disiplinore patjetër të zbatohen në mënyrë restriktive, me mbrojtje të veçantë për gratë shtatzëna dhe nënat.

Kontakti me familjen dhe fëmijët paraqet komponent thelbësor të trajtimit të të burgosurave femra. Në praktikë, gratë shumë shpesh janë kujdestare kryesore të fëmijëve, ndërsa privimi nga liria ka pasoja të drejtpërdrejta dhe afatgjatë në jetën e tyre familjare.

Këto Rregulla njëkohësisht kërkojnë lehtësimin e kontakteve me fëmijët, krijimin e kushteve për vizita të përshtatura për fëmijët edhe duke marrë parasysh lidhjet familjare gjatë sistemimit në ente. Në atë kontekst, vendndodhja gjeografike e SHNP Strugë mund të jetë një përparësi, por vetëm nëse është i shoqëruar me politika dhe infrastrukturë të përshtatshme.

Personeli paraqet faktor kyç për transformim të suksesshëm. Riorientim drejt punës me popullatën e të burgosurave femra kërkon jo vetëm rritje të pjesëmarrjes së zyrtareve femra, por edhe trajnime sistematike për qasje të ndjeshme gjinore, njohjen e traumës dhe punë me grupe të cënueshme.

Rregullat qartë tregojnë se pa personel të trajnuar në mënyrë adekuate, edhe zgjidhjet më të mira normative mbeten formale dhe joefektive në praktikë.

Në fund, **transformimi i SHNP Strugë në ent për persona të dënuar të gjinisë femërore duhet të kuptohet si proces, i cili kërkon planifikim strategjik, koordinim ndër-sektorial dhe mbikëqyrje të vazhdueshme. Përputhshmëria me Rregullat e Bangkokut nuk duhet të trajtohet si një detyrim shtesë, por si standard minimal për trajtim human dhe dinjitoz.**

Duke e pasur parasysh këtë, në suaza të mandatit tonë si Mekanizëm Parandalues Nacional dhe në përputhje me resurset në dispozicion (si kadrovike ashtu edhe materiale), në vazhdimësi

do të monitorojmë nëse transformimi i paralajmëruar dhe eventual sjell realisht përmirësimin e pozitës dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të gjinisë femërore të privuar nga liria

5.3 ENTI NDËSHKUES PËRMIRËSUES BURGU I OHRIT

Në ENP Burgun e Ohrit dërgohen:

- a) fëmijë të gjinisë mashkullore të dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm për fëmijë dhe
- b) persona të gjinisë mashkullore dhe femërore të cilët me masë të caktuar paraburgim nga rajoni i gjykatave themelore: Ohër, Strugë dhe Dibër¹⁹.

Theksi i kësaj vizite ishte shqyrtimi i trajtimit të fëmijëve, të cilët janë dërguar për të vuajtur dënimin me burg për fëmijë, për këtë arsye në tekstin e mëtejshëm mund të shfrytëzohet edhe termi burg për të mitur. Edhe pse një pjesë e këtyre personave janë tashmë të moshës madhore, në vijim termi fëmijë i referohet edhe atyre.

Sa u përket kushteve materiale të burgut, ekipi i MPN-së konstatoi se gjendja në pjesën më të madhe mbetet e pandryshuar në krahasim me vizitat e mëparshme të realizuara. Konkretisht, burgu për të mitur dhe pjesa e paraburgimit janë të vendosura në të njëjtin objekt në qendër të Ohrit, të rrethuara nga ndërtesa banimi që "mbivendosen" drejtpërdrejt mbi objektin e Burgut, përkatësisht mbi hapësirën qendrore të paraparë për sport, rekreacion dhe aktivitete të lira. Ekipi i MPN-së menjëherë konstatoi se personat e privuar nga liria në këtë objekt janë të ekspozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj shikimeve si dhe mundësisë së komenteve dhe hedhjeve të fjalëve nga banorët përreth, me çka cenohet anonimiteti dhe privatësia e tyre. Objekti i entit daton që nga viti 1959/60 si pjesë e Stacionit Policor, ndërsa në vitet 1962/63 është ndarë si institucion i posaçëm ndëshkues-korrektues.

Në momentin e vizitës, në institucion ishin të vendosur gjashtë persona të dënuar me burg për fëmijë. Për kapacitetin real të pjesës për të mitur nuk ka numër të saktë, sepse hapësirat ku vendosen persona të dënuar të moshës së mitur janë më të mëdha dhe mundësojnë vendosjen e më shumë shtretërve, varësisht nga numri i personave të dënuar me burg për fëmijë.

Nga inspektimi i tri hapësirave ku ishin të vendosur fëmijët, ishte konstatuar se nga aspekti i sipërfaqes, këto hapësira i përmbushin standardet. Hapësirat janë me madhësi të ndryshme – 32m², 22m² dhe 16m² dhe në të gjitha ishin të vendosur nga dy të mitur.

Megjithatë, në pjesën e kushteve të tjera materiale nuk mund të thuhet se ato janë në rregull sepse mungojnë shumë gjëra. Shtretërit janë të vjetër, çdo dhomë dallon nga tjetra, ndërsa dollapët për ruajtjen e rrobave dhe të ushqimit janë të amortizuar dhe shumë të vegjël. Sa i përket ngrohjes, ishte theksuar se ngrohja qendrore funksionon vetëm disa orë në ditë, por gjatë inspektimit në vendngjarje ishte matur temperaturë nën 18°C, që është nën standardet minimale. Gjithashtu, lagështia ishte mbi 65%, që paraqet kufirin e sipërm të lejuar. Sa u përket

¹⁹ VENDIM PËR SISTEMIM TË PERSONAVE TË BURGOSUR SI DHE TË FËMIJËVE NË ENTET NDËSHKUESE-PËRMIRËSUESE DHE EDUKUESE-PËRMIRËSUESE SI DHE TË PERSONAVE TË PARABURGOSUR NË REPARTET PËR PARABURGIM NË ENTET NDËSHKUESE-PËRMIRËSUESE, - numri i Gazetës Zyrtare: 34/2025

hapësirave tjera ishte notuar se hapësira për qëndrim ditor ku zhvillohen aktivitete të ndryshme si trajnime, mësimet etj., është shumë e amortizuar dhe nevojitet që urgjentisht të ndërmerren masa për rinovimin e saj. Në këtë hapësirë ende përdoret sobë me dru për ngrohje.

Problem të madh për fëmijët paraqet edhe qasja deri te tualetet, pasi ato ndodhen në hapësirën për qëndrim ditor. Gjatë orëve të natës, kur fëmijët janë të vendosur në dhomat e tyre, nevojitet që një person zyrtar t'ua hapë dyert që të mundën të shkojnë në tualet. Tualetet të cilat ndodhen në këtë hapësirë janë në gjendje të gjendje të keqe, gjithashtu në gjendje të keqe është edhe tualeti i cili gjendet në katin përdhësë, përkatësisht në oborrin e shëtitorës. Për të njëjtën ishte theksuar se ishte rinovuar së fundmi, por nga inspektimi në vendngjarje ishte e qartë se punimet nuk ishin kryer siç duhet. Ndihej erë e pakëndshme, gjë që pjesërisht lidhet edhe me nevojën për përkujdesje më të madhe për higjienën.

Dushet ndodhen në një pjesë të veçantë brenda vetë oborrit, kështu që pas dushit fëmijët patjetër duhet të dalin jashtë dhe pastaj të ngjiten në dhomat e tyre, kjo paraqet problem sidomos në kushte dimërore.

Sa u përket aktiviteteve të tjera në dispozicion, burgu posedon palestër, por pa shumë pajisje. Në oborr ka një kosh për të luajtur basketboll, dy porta për futboll, si dhe disa karrige për t'u ulur.

Ushqimi fëmijëve shërbehet në mensë e cila është e ngjitur me kuzhinën. Kuzhina ku përgatitet ushqimi është e vogël për nga dimensionet, por i përmban elementet e nevojshme themelore, ndërsa ushqimi i përgatitur konsumohet në mensë.

Parku i automjeteve të institucionit përbëhet nga tri automjete zyrtare, përkatësisht një veturë dhe dy furgonë transporti, prej të cilave njëra ishte e vjetër dhe mund të përdoret vetëm brenda qytetit, për çka u theksua se ato janë të pamjaftueshme për realizimin e nevojave të institucionit.

Sa i përket gjendjes kadrovike, ekipi i MPN-së konstatoi se numri **aktual i të punësuarve nuk i plotëson nevojat për ushtrimin e papenguar të funksionit, të cilin duhet ta realizojë një ent i këtij lloji. Ekipi i MPN-së evidentoi se personat zyrtarë, përkaj pjesës së burgut, ku janë të vendosur fëmijët, të cilët kanë të shqiptuar dënim me burg, e mbulojnë edhe pjesën e paraburgimit.**

Gjatë kohës së vizitës ishte konstatuar se entin e shërben vetëm një psikolog i cili është i punësuar në mënyrë të rregullt, për dallim nga vizitat e mëparshme kur kishte dy psikologë. Nuk ka punësime të profileve të tjera, si pedagog, punëtor social apo edukatorë. Një herë në javë janë në disponim shërbimet e mjekut të përgjithshëm, i cili i ridërgon të rinjtë deri te kontrolle plotësuese specialiste, përfshirë edhe ato psikiatrike. Në rast nevojë ftohet edhe Ndihma e Shpejtë Mjekësore (NSHM) për çka ishte theksuar se posaçërisht sfiduese është gjatë periudhës së verës, kur në qytet ka numër të madh turistësh dhe ekipet e NSHM-së kanë ngarkesë të madhe në punë.

Duke e pasur parasysh këtë gjendje, ekipi i MPN-së edhe në Raportin e Veçantë theksoi se *përkujdesja për të miturit në burg kërkon përpjekje të posaçme që të zvogëlohen rreziqet e papërshtatshmërisë sociale afatgjate. Duke e marrë parasysh këtë, nevojitet qasje multidis-*

²⁰ Fragment nga Raporti i 9-të i Përgjithshëm i KPT-së, i publikuar në vitin 1999, Të miturit e privuar nga liria, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor apo Poshtëruer (KPT)

ciplinare e cila do t`i përmbajë aftësitë e profesionistëve të ndryshëm (duke përfshi mësues, trajnues, punëtorë socialë, psikologë) me qëllim që t`u përgjigjet nevojave të posaçme të të miturve në suaza të një mjedisi të sigurt edukativ dhe socio-terapeutik.²⁰

Pikërisht, problemi me mosplotësimin e vendeve të punës në institucionet ku realizohet privimi nga liria është objekt shqyrtimi edhe i Komitetit për Parandalim të Torturës i Këshillit të Evropës, i cili në këtë drejtim thekson se: „... në vendet ku plotësimi i numrit të personelit është i pamjaftueshëm, mund të paraqitet nevoja për punë jashtë orarit me qëllim të ruajtjes së nivelit bazë të sigurisë dhe të rendit në institucion. Kjo gjendje mund të rezultojë lehtësisht në një nivel më të lartë të presionit ndaj personelit dhe në humbjen e parakohshme të motivimit për punë, kjo gjendje ka gjasa të përkeqësojë tensionet e natyrshme për çdo mjedis të burgut²¹.

*Njëkohësisht, theksohet se: "Vendosja e marrëdhënieve pozitive ndërmjet personelit dhe të burgosurve, gjithashtu varet në masë të madhe edhe nga ekzistimi i një numri adekuat i personelit të pranishëm në çdo kohë në hapësirat e burgut dhe në vendet të cilat të burgosurit i përdorin për aktivitete të lira. **Mungesa e përgjithshme e personelit dhe/ose shpërndarja e papërshtatshme e cila i zvogëlon mundësitë për kontakte të drejtpërdrejta me të burgosurit, sigurisht që do ta pengojnë zhvillimin e marrëdhënieve pozitive dhe në përgjithësi do të krijojë një mjedis të pasigurt, si për personelin, ashtu edhe për të burgosurit²².***

Problem shtesë paraqet edhe trajnimi i pamjaftueshëm i kuadrit të sapoproanuar dhe kjo rezulton me trajtim të papërshtatshëm ndaj fëmijëve, por edhe ndaj personave të privuar²³. Këtu, ekipi i MPN-së thekson se **personeli që duhet ta përmbushë atë detyrë duhet të zgjidhet me kujdes duke u bazuar në pjekurinë personale dhe aftësinë për t`u përballur me sfidat të cilat i sjell puna, por edhe sigurimin e mirëqenies së kësaj grupmoshe. Më konkretisht, ata duhet të jenë të përkushtuar për punë me të rinjtë dhe të jenë në gjendje të udhëheqin dhe të motivojnë të miturit që janë nën përgjegjësinë e tyre. I gjithë ky personel, duke përfshi edhe atë me detyrat e rojës, duhet të pajiset me trajnim profesional gjatë të vepruarit dhe punës, si dhe të shfrytëzojë përkrahje të jashtme gjatë realizimit të obligimeve të tij²⁴.**

Video-mbikëqyrja paraqet problem shtesë sepse jo gjithmonë është funksional. Duke pasur parasysh se shpeshherë ndërrimet e natës mbulohen me vetëm tre persona zyrtarë, mosfunksionimi i sistemit të video-mbikëqyrjes e vështirëson edhe më shumë të gjithë situatën. Në momentin e vizitës 4 kamera nga gjithsej 16 kamerat ekzistuese nuk funksiononin.

Një nga çështjet e cila një kohë të gjatë lidhet drejtpërdrejt me këtë institucion është dislokimi i burgut për fëmijë. Ky problem edhe më tutje vazhdon të mbetet aktual, edhe pse personat zyrtarë janë të mendimit se nevojitet ndërtimi i një burgu krejtësisht të ri ose transferimi i fëmijëve në ENP Vollkovi, objekt me kapacitet më të madh si dhe me kushte më të mira materiale.

²¹ Fragment nga Raporti i 11-të i Përgjithshëm (CPT/Inf (2001) 16) i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës

²² Ibid

²³ Konstatim i dhënë nga njëri prej të punësuarve me të cilët ekipi i MPN-së zhvilloi bisedë.

²⁴ Fragment nga Raporti i 9-të i Përgjithshëm i KPT-së, i publikuar në vitin 1999, Të miturit e privuar nga liria, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor apo Poshtëruer (KPT)

Sa i përket trajtimit të fëmijëve dhe qasjes ndaj tyre, gjatë bisedës me person zyrtar ishte theksuar se respektohet plotësisht procedura ligjore. Duke e pasur parasysh se mungesa e arsimit formal zvarritet një periudhë të gjatë kohore, gjatë kësaj vizite ishte ndarë informacioni se pritet konfirmimi formal nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pas së cilës do të përfshihen në procesin e rregullt arsimor. Në momentin e vizitës, Kryqi i Kuq i Maqedonisë çdo të mërkurë organizon kurs të gjuhës angleze, dhe përveç këtij kursi, institucioni organizon punëtori kreative, si dhe sesione individuale.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, fëmijëve u organizohen edhe punëtori edukative për shëndet mendor, zgjidhjen e konflikteve, të sëmundjeve të varësisë si dhe të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, HIV dhe SIDA.

Fëmijët mbajnë kontakte të rregullta me botën e jashtme, përkatësisht me prindërit dhe më të afërmit. Si ditë për vizita janë caktuar ditët e fundjavës, por lejohen edhe vizita të jashtëzakonshme. Nëpërmjet telefonit, fëmijët mund të bisedojnë të hënën dhe të premten pa ndonjë kufizim më të madh.

Nuk janë evidentuar konflikte ndërmjet fëmijëve, as edhe përplasje verbale të një natyre më serioze.

Në bisedë me fëmijët ishin siguruar informacione se gjatë kontrollove mjekësore pothuajse gjithmonë lidhen dhe kontrollohen në prezencë të personit zyrtar nga burgu.

Në këtë drejtim, ekipi i MPN-së rekomandon që **kontrollat mjekësore të realizohen pa mbikëqyrjen e policëve të burgut, përveç në raste të jashtëzakonshme kur personeli mjekësor do të vlerësojë se ekziston nevoja për atë.**

Në këtë drejtim, ekipi i MPN-së bën thirrje për respektimin e plotë të dispozitave të "Rregullores për rendin shtëpiak për zbatimin e masës së paraburgimit në repartet e paraburgimit të burgjeve", ku është paraparë që **"kontrolli mjekësor realizohet pa prezencën e përfaqësuesit të policisë së burgut menjëherë, e më së voni brenda 24 orëve nga pranimi i personit të paraburgosur."**²⁵

Gjatë bastisjes, fëmijët me të cilët u bisedua theksuan se zhvishen plotësisht dhe detyrohen që të bëjnë ulje-ngritje dhe pompa, për shkak të së cilës ekipi i MPN-së theksoi se bastisja, përkatësisht **kontrolli i të burgosurve nuk duhet të realizohet me zhveshje të tërësishme, por ajo duhet të realizohet në mënyrë parciale (në fillim pjesa e sipërme e rrobave dhe pasi të vishen ato, të vazhdohet me zhveshjen e pjesës së poshtme të rrobave). Mënyra e këtyre realizimit të kontrollimit e ruan dinjitetin e personave (këtu vihet theks i veçantë në faktin se bëhet fjalë për fëmijë, përkatësisht persona të rinj), dhe nuk i ekspozon ata ndaj trajtimit apo ndëshkimit shtesë çnjerëzore ose degradues. Çdo kontroll i zgavrave të brendshme trupore patjetër të kryhet nga një person profesionist – mjek, por jo nga mjeku i ngarkuar për mirëqenien e tyre të rregullt shëndetësore. Ky lloj kontrolli duhet të evidentohet në mënyrë zyrtare duke përfshirë informacion për personin që kryen kontrollin dhe personat tjerë të pranishëm gjatë kryerjes së tij.**

Gjatë vizitës së Burgut të Ohrit, ekipi i MPN-së realizoi mbikëqyrje edhe në librat për evidencë të cilat udhëhiqen për të dënuarit e moshës së mitur. Nga mbikëqyrja e realizuar në evi-

²⁵ Neni 10 paragrafi (2) i Rregullores („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 87/20)

dencën për përdorimin e mjeteve për detyrim, ekipi i MPN-së konstatoi se më vitin 2025 deri në ditën e vizitës nuk ka pasur raste të tilla, si dhe në vitet deri në vitin 2021.

Nga kontrolli i realizuar në evidencën për masat disiplinore të shqiptuara ishte notuar se gjatë rrjedhës së vitit 2025, deri në ditën e vizitës, janë regjistruar gjithsej 2 procedura disiplinore, ku janë shqiptuar sanksione dërgimi në dhomë të veçantë, prej të cilave në njërin rast me kohëzgjatje prej 7 ditëve, ndërsa në rastin tjetër me kohëzgjatje prej 3 ditëve. Ishte notuar edhe një sanksion disiplinor, edhe atë dërgimi në dhomë të veçantë për një fëmijë, i cili është arratisur, por ky rast ishte regjistruar në librin e arratisjeve edhe atë si rast i vetëm në 5 vitet e fundit.

Nga kontrolli i realizuar në dokumentacionin tjetër, ekipi i MPN-së vuri në dukje se personat ndaj të cilëve ishte zhvilluar procedurë disiplinore në Burgun e Ohrit kanë qenë të informuar për shkaqet për të cilat është iniciuar procedura, kanë qenë të dëgjuar personalisht dhe kanë dhënë deklaratën e tyre në lidhje me ngjarjen në fjalë për të cilën udhëhiqet procedura, u është mundësuar të ofrojnë dëshmitë e tyre si dhe t'i shqyrtojnë dëshmitë kundër tyre, gjithashtu u dorëzohet edhe një shembull i vendimit për masën disiplinore, me udhëzim se personi ka të drejtë që të ankohet deri te drejtori i Drejtorisë së Ekzekutimit të Sanksioneve.

Nga kontrolli i realizuar në dokumentacion ishte konstatuar se në rastet kur shqiptohet masa disiplinore – dërgimi në dhomë të veçantë, gjithmonë ekziston mendim mjekësor në lidhje me aftësitë e personit të dënuar për t'u përballur dhe të vuajtur masën disiplinore të shqiptuar, por nuk u pranuan informacione nëse personat të cilët ndodhen në dhomë të veçantë, vizitohen çdo ditë nga ana e mjekut.

Nga mbikëqyrja e realizuar në Librin e evidencës për kontrollet e realizuara të personave të dënuar të moshës së mitur si dhe të personave të paraburgosur, ku vërehen lëndime dhe plagë të dukshme gjatë pranimit ose gjatë vuajtjes së dënimit me burg në ent, ishte konstatuar se për vitin 2025 nuk është evidentuar asnjë rast i lëndimeve të personave të dënuar të moshës së mitur. Megjithatë, ishin evidentuar 5 raste të lëndimeve të personave të moshës së mitur në repartin e paraburgimit.

Mekanizmi Parandalues Nacional i drejtoi këto rekomandime deri te Burgu për Fëmijë Ohër:

1. Në mënyrë urgjente të sanohen nyjat sanitare në ent;
2. Kontrollet shëndetësore të kryhen pa mbikëqyrje të personit të uniformuar zyrtar, përveç në raste urgjente të jashtëzakonshme kur personi mjekësor i cili kryen kontrollin frikësohet për sigurinë e tij.

Deri te Drejtoria e Zbatimit të Sanksioneve u drejtuan rekomandimet si në vijim:

3. Të ekipohet personeli civil dhe i uniformuar i Burgut të Ohrit, në përputhje me sistematizimin e vendeve të punës;
4. Gjatë pranimit të personave të ri, detyrimisht të zhvillohen trajnime në pajtim me natyrën e punës si dhe trajnime në fushën e të drejtave të njeriut, përkatësisht ndalimi i torturës dhe i formave tjera të trajtimit ose të ndëshkimit të papërshtatshëm ndaj personave të privuar nga liria.

Në përgjigjen e pranuar nga Drejtoria e Zbatimit të Sanksioneve dhe nga Burgu i Ohrit është konfirmuar veprimi sipas rekomandimeve të dhëna edhe pse ata me karakter financiar p.sh. punësimet, varen nga mundësitë financiare, përkatësisht miratimet e siguruara nga Ministria e Financav.

5.4 ENTI NDËSHKUES-PËRMIRËSUES IDRIZOVË

INP-ENP Idrizovë ishte vizituar për shkak të mbledhjes së informacioneve në lidhje me gjendjen aktuale dhe të përditshme në ent, nëpërmjet zhvillimit të bisedës me personat zyrtarë.

Në këtë ent problem me karakter serioz i cili një periudhë të gjatë është i pranishëm është mbrojtja shëndetësore e personave të dënuar, si dhe sigurimi i tyre shëndetësor. Në lidhje me mbrojtjen shëndetësore ishte notuar sfida me personelin shëndetësor, i cili nuk mund që gjithmonë t' u përgjigjet nevojave të të dënuarve në kohën e duhur, kurse në pjesën e sigurimit shëndetësor ishte theksuar se edhe pse paraqitja e personave të dënuar nga ana e INP-ENP Idrizovë bëhet rregullisht dhe në kohë, për shkak të mospërputhjeve softuerike, pagesa e sigurimit nga ana e Drejtorisë së Ekzekutimit të Sanksioneve vonohet. Vonesa e këtillë akumulon borxhe në llogari të entit penitenciarë (e cila për një periudhë të gjatë ka qenë e bllokuar), ndërsa shërbimet shëndetësore për të burgosurit paguhen privatisht, përkatësisht njëjtë si për persona të pasiguruar.

Në lidhje me numrin e të punësuarve në policinë e burgut dhe në personelin tjetër, në momentin e vizitës u konstatua se ishte shpallur një konkurs për 80 punësime të reja, nga të cilat 66 vende ishin për policinë e burgut, kurse pjesa tjetër ishin të ndara në pjesën e risocializimit si dhe në administratë. Edhe pse në pamje të parë krijohet përshtypja se numri i personelit në ent në vazhdimësi rritet, megjithatë edhe më tej është i pranishëm largimi i kuadrit për arsye të ndryshme, pensionim, suspendim, pushim nga puna.

Sa i përket gjendjes me personat e dënuar dhe para së gjithash kushteve materiale, ishin siguruar informacione se kategorizimi i të dënuarve respektohet dhe nuk ekziston më përzierja e personave të dënuar me trajtime të ndryshme në të njëjtin vend. Për shkak të mbipopullimit është rinovuar edhe krahu i tetë ku janë vendosur nga 4 deri në 6 persona në një dhomë, me çka janë lehtësuar edhe krahët tjerë të objektit "ndërtesë", ku janë të vendosur të dënuar me regjim të mbyllur.

Në vitin 2024 ka qenë i rinovuar krahu u pestë, por edhe pse e rinovuar, gjendja atje sa u përket kushteve materiale është përkeqësuar për shkak të një sërë rrethanash (mbipopullimi, kapaciteti i përkufizuar i nyjave higjenike, por edhe për shkak të shprehive personale higjenike).

Mbipopullimi me persona të dënuar gjatë kohës së vizitës së MPN-së, ishte i pranishëm edhe në "repartin e grave", ku ishin regjistruar 90 të dënuara, ndër të cilat edhe një vajzë e moshës së mitur me masë edukative-korrektuese të shqiptuar. Vajza ishte në INP-ENP Idrizovë e izoluar nga të dënuarat tjera për shkak të mungesës së kushteve adekuate nga aspekti i segregimit nga të miturit meshkuj në EKP Tetovë. Nga ana e kuadrit udhëheqës ishte theksuar se punohet në zgjidhjen e këtij problemi (po ndërtohet mur rreth pavijonit të paraparë për të miturat femra me qëllim parandalimin e arratisjes në entin Vollkovi), më pas u siguruan informacione se edhe vajza ishte transferuar në EKP Tetovë.

Problemi, i cili për një kohë të gjatë zvarritet në repartin e grave është edhe furnizimi me ujë të ngrohtë. Për këtë, ishin siguruar informacione se ishin përpjekur që të sigurohen mjete nga Qeveria për blerjen e paneleve, por mjetet nuk janë miratuar.

Gratë nga ky repart janë të angazhuara në prodhim, në punëtoritë e qepjes e të ngjashme, ndërsa aktivitete të natyrës së përafërt për të dënuarit meshkuj nuk ka.

Sa i përket kontrolleve mjekësore për gratë p.sh., gjinekologjike, u siguruan informacione se ato kryhen rregullisht, përkatësisht çdo 6 muaj.

5.5 ENTI EDUKATIV-KORREKTUES TETOVË

Mekanizmi Parandalues Nacional, me qëllim të identifikimit të rreziqeve të mundshme nga tortura ose formë tjetër i trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës edhe në mars të vitit 2025 realizoi vizitë në Entin Edukativ-Korrektues Tetovë, me theks në gjendjen me shëndetin mental dhe nevojat psikosociale të personave të rinj të vendosur aty. Për realizimin e vizitës, si ekspert i jashtëm ishte angazhuar dr. Silvana Markovska-Simoska, specialist i psikiatrisë për fëmijë dhe adoleshentë.

Të dhëna të përgjithshme për entin:

Enti Edukativ-Korrektues (EEK) Tetovë është ent, në të cilin deri më tani ishin të dërguar fëmijë të gjinisë mashkullore, të cilëve me vendim të plotfuqishëm u është shqiptuar masa edukative dërgim në ent edukativ-korrektues për territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut²⁶. Në pajtim me ndryshimet e Ligjit për Ekzekutim të Sanksioneve²⁷, neni 34 paragrafi (6) të miratuar në vitin 2024, vajzat ndaj të cilave është shqiptuar masa edukative-korrektuese dërgim në entin edukativ-korrektues të cilat deri më tani këtë masë e vuanin në INP-ENK Idrizovë – reparti i grave, do të dërgohen në EEK Tetovë.

EEK Tetovë është i vendosur në një kompleks të mbyllur me karakter karceal me sipërfaqe prej rreth 16.000 m², jashtë zonës urbane me lidhje të kufizuara transporti. Ai ndodhet në Komunën e Bërvenicës, pranë fshatit Vollkovi. Edhe pse ka rrugë të asfaltuar, transporti publik nuk është siguruar, gjë që e vështirëson qasjen dhe kontaktin e fëmijëve me familjet e tyre. Vendosja në një ent të veçantë është në përputhje me standardet ndërkombëtare, por gjithashtu parashikojnë qasje të lehtë dhe nxitje të integritimit social. Në këtë drejtim, **MPN-ja thekson nevojën për masa për përmirësimin e qasjes dhe forcimin e lidhjeve me familjet dhe komunitetin.**

Enti ka kapacitet për 110 fëmijë, me sipërfaqe totale neto prej rreth 3.500 m², prej të cilave 1.920 m² janë të dedikuara për vendosje. Standardet evropiane rekomandojnë njësi më të vogla për vendosje me numër të kufizuar të shfrytëzuesëve, gjë që mundëson përkujdesje të individualizuar. Duke e pasur parasysh numrin mesatar të fëmijëve deri më tani, hapet çështja e arsyeshmërisë të një kapaciteti të tillë. Megjithatë, duke marrë parasysh ndryshimet në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve si dhe spekulimet të cilat një kohë të gjatë qarkullojnë në opinionin profesional se ky institucion do të jetë ent edhe për të miturit nga Burgu i Ohrit, atëherë bëhet më e qartë edhe nevoja për ndërtimin e një enti me një kapacitet të tillë..

MPN thekson se fëmijët me masë edukuese-korrektuese nuk duhet të vendosen së bashku me fëmijët të cilëve u është shqiptuar dënimi me burg, as të përzihen me kat-

²⁶ “Vendim për sistemimin e personave të dënuar dhe të fëmijëve në institucionet ndëshkuese-përmirësuese dhe edukativo-përmirësuese, si dhe të personave të paraburgosur në repartet e paraburgimit të institucioneve ndëshkuese-përmirësuese“, numri i Gazetës Zyrtare: 10/2020, data e publikimit në Gazetën Zyrtare: 16.01.2020

²⁷ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 74/2024.

egori dhe fëmijë të gjinive të ndryshme, për shkak të rrezikut të shtuar nga trajtimi i papërshtatshëm, posaçërisht në kushte me resurse të kufizuara.

Në pjesën e ekipimit kadrovik, shërbimi profesional disponon me numër të kufizuar të të punësuarve, me ulje shtesë për shkak të pensionimit. Përkaj këto profesional, në institucion janë të angazhuar edhe pjesëtarë të policisë së burgut, personel administrativ dhe drejtor. Nuk janë paraparë punësime të reja, ndërsa institucioni përballet me resurse të kufizuara financiare.

MPN përdëfton në nevojën për plotësimin e kuadrit, posaçërisht në fushën e trajtimit dhe çështjeve profesionale-instruktive, si dhe vendosjen e procedurave të përshtatshme për përzgjedhjen e personelit që punon me fëmijët, duke u bazuar në kompetencat profesionale dhe personale.

Arsimi:

Në përputhje me të dhënat e siguruar gjatë vizitës si dhe nga gjendja e konstatuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, rezulton se vetëm njëri nga fëmijët ndjek mësimin në një shkollë të mesme në Tetovë. Në momentin e vizitës nuk kishte proces të rregullt arsimor për fëmijët në institucion, kurse arsyeja zyrtare për këtë është zvarritja e procedurës legjislative në lidhje me zgjidhjet ligjore me të cilat do të rregullohet çështja e kompetencës për organizimin e procesit arsimor në institucion.

Megjithatë, si një ndryshim pozitiv i evidentuar pas vizitës së ekipit të MPN, është fakti se ndërkohë ka filluar procesi arsimor në EEK Tetovë. Konkretisht, me fillimin e vitit shkollor 2025/2026, për fëmijët e vendosur në EEK Tetovë është mundësuar zhvillimi i rregullt i mësimin për arsimin fillor dhe të mesëm, përmes angazhimit të kuadrit mësimor nga shkolla tashmë rajonale „Anton Semjonoviç Makarenko“ për nivelin fillor dhe nga Qendra Rajonale për Arsim Profesional „Mosha Pijade“ për nivelin e mesëm.

Vlerësimi i shëndetit mendor:

Në dekadën e fundit është vërejtur vëmendje e shtuar ndaj shëndetit mendor të fëmijëve në kontakt me sistemin penal, duke përfshi edhe atë të vendosur në institucione edukuese-korrektuese. Këta fëmijë më shpesh përballen me çrregullime mendore në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre nga popullata e përgjithshme, gjë që i bën kategori veçanërisht të cenueshme.

Hulumtimet tregojnë për një përhapje të lartë të vështirësive psikologjike, më së shpeshti të lidhura me agresivitetin, kontrollin e dobët të impulseve dhe përvojat e mëparshme negative. Ndër situatat më të shpeshta janë çrregullimet në disponim dhe sjellje, sjellje suicidale, çrregullime hiperkinetike dhe abuzimi me substanca psikoaktive. Në mënyrë plotësuese, këta fëmijë shpesh kanë arritje më të ulëta arsimore, resurse të kufizuara sociale dhe vështirësi në integrimin social.

Nevojat e kësaj popullate janë të ndryshme dhe jo çdo çrregullim psikik kërkon trajtim medikamentoz. Edhe pse barnat psikiatrike mund të ndihmojnë, ekziston rreziku i përdorimit të tyre në mënyrë jo adekuate si mjet për kontrollimin e sjelljes. Kjo i bën posaçërisht të cenueshëm fëmijët në sistemin penal ndaj terapisë së tepruar, duke e pasur parasysh mundësinë e tyre të kufizuar, për zgjidhje. Prej këtu, skringu sistematik dhe vlerësimi i shëndetit mental si dhe i nevojave psikosociale paraqesin parakusht kyç për sigurimin e përkujdesjes dhe mbështetjes adekuate.

Në institucion ishin identifikuar fëmijë me nevoja specifike shëndetësore dhe zhvillimore, për të cilët është siguruar trajtim adekuat dhe mbrojtje nga stigmatizimi. Ishin realizuar kontakte individuale me një pjesë të fëmijëve të pranishëm, në kushte të cilat mundësojnë besueshmëri dhe komunikim papengesa. Të gjithë ishin të gjinisë mashkullore, ndërsa dominojnë pjesëtarë të pakicave etnike. Niveli arsimor është i ulët, një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve nuk e kanë të përfunduar arsimin fillor dhe të njëjtët kanë aftësi të kufizuara të shkrim-leximit.

Mbrojtja shëndetësore në institucion sigurohet nëpërmjet një mjeku të përgjithshëm, i cili është i pranishëm njëherë në javë dhe fëmijët i udhëzon në kontrolle plotësuese specialistike duke përfshirë edhe ato psikiatrike. Edhe shërbimi stomatologjik është i disponueshëm për përkujdesje bazike në suaza të institucionit. Në bashkëpunim me institucionet shëndetësore, është siguruar edhe përkujdesje psikiatrike sipas nevojës.

Si risi pozitive është angazhimi i teknikut mjekësor me orar të plotë, i cili sipas nevojës intervenon edhe jashtë orarit të punës. Në mungesë të mjekut, thirret ndihma e shpejtë. Megjithatë, këtu patjetër duhet të theksohet se tekniku nuk ka kaluar trajnim paraprak për punë me fëmijë në rrezik.

Kontrollet e para shëndetësore realizohen brenda një afati të shkurtër pas pranimit, por ata nuk përfshijnë testime për drogë dhe as mbikëqyrje të plotë në dokumentacionin e mëparshëm mjekësor (duke përfshirë edhe sëmundjet infektive). Nuk udhëhiqet evidencë për statusin e vaksinimit të fëmijëve, gjë që përbën mangësi serioze. Terapinë e administron tekniku mjekësor, ndërsa në mungesë të tij këtë e bën personeli tjetër, duke u bazuar në doza të përgatitura paraprakisht. Është vërejtur përmirësimi në mënyrë të shpërndarjes si dhe të evidentimit të terapisë, e cila udhëhiqet në mënyrë elektronike.

Terapia ampulare jepet ekskluzivisht sipas urdhërësës së mjekut. Pjesa më e madhe e fëmijëve pranojnë terapi të caktuar gjatë rrjedhës së ditës. Në lidhje me furnizimin me vitamina, ajo realizohet nga ana e teknikut mjekësor, me rimbursim të mëvonshëm nga institucioni.

Shëndeti mendor dhe nevojat psikosociale:

Fëmijët e vendosur në ENK Tetovë në përgjithësi u shprehën të kënaqur me kushtet në ent. Për dallim nga raportet e mëparshme, nuk u shprehën ankesa për qasje të kufizuar deri te telefoni ose aktivitetet të lira, por ishte theksuar se kanë komunikim të rregullt dhe përkrahje nga edukatorët. Te fëmijët vërehen nivele të ndryshme të gjendjes mendore dhe emocionale. Më shpesh janë të pranishme simptomat e ankthit dhe të depresionit (frikë, pagjumësi, mungesë e shpresës), vështirësi gjatë kontrollimit të agresivitetit si dhe vetëbesim të ulët.

Te një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve janë përcaktuar diagnoza psikiatrike, më shpesh të lidhura me çrregullime ankthi, çrregullime të gjumit, varësi dhe çrregullime të sjelljes. Një pjesë e fëmijëve pranojnë terapi farmakologjike, ku dominon përdorimi i anksiolitikëve dhe terapisë për gjumë, kurse një numër i vogël është me terapi më komplekse psikiatrike ose me antidepresivë. Ka edhe raste me probleme shëndetësore somatike.

Shërbimet psikiatrike sigurohen jashtë institucionit, gjë që e kufizon besueshmërinë dhe vazhdimësinë e trajtimit. Kontrollet nuk janë të rregullta, ndërsa sfidë shtesë paraqet fakti që trajtimin e realizojnë psikiatër për të rritur, në vend të specialistëve të psikiatrisë së fëmijëve dhe adoleshentëve.

Dominojnë vështirësitë psikologjike si shqetësimi, tensioni, imazhi negativ për veten dhe reagime destruktive-stresuese. Janë vërejtur edhe lëndime si rezultat i reagimeve impulsive. Një pjesë e fëmijëve kanë histori për keqpërdorim të substancave psikoaktive, ndërsa nuk ekziston trajtim sistematik për gjendjen e abstinencës. Megjithatë, fëmijët identifikojnë edhe mekanizma pozitivë për përbalim, si aktivitete sportive, muzikë, mbështetje reciproke dhe kontakti me familjen. Posaçërisht theksohet interesi për trajtimet profesionale dhe nevoja për përmirësimin e tyre.

Dokumentacioni mjekësor në përgjithësi udhëhiqet në mënyrë të rregullt, por janë vërejtur lëshime të caktuara, si hapja e më shumë kartelave për të njëjtin fëmijë dhe përzjerja e raporteve mjekësore midis dosjeve. Në institucion nuk aplikohet terapi me psikostimulantë për shkak të mungesës së tyre, megjithëse ekzistojnë indikacione se një pjesë e popullatës do të ketë nevojë për një trajtim të tillë. Nga terapia e cila është në disponim, më shpesh përdoren anksiolitikët dhe barnat për gjumë, ndërsa një numër më i vogël i fëmijëve janë në terapi më komplekse psikiatrike. Janë vërejtur rreziqe të lidhura me polimedikamentë, si dhe mundësia e zhvillimit të tolerancës dhe

varësisë, posaçërisht te anksiolitikët. Për këtë shkak, është i nevojshëm monitorimi i rregullt mjekësor, ndjekje me kujdes e terapisë dhe shqyrtimi i qasjeve alternative, jofarmakologjike, duke përfshi edhe psikoterapinë.

Gjendja shëndetësore mendore e fëmijëve është komplekse dhe kërkon mbështetje të vazhdueshme profesionale si dhe qasje të korrduar midis personelit shëndetësor dhe edukatorëve.

Konstatime dhe rekomadime përfundimtare:

Konstatimet në masë të madhe përputhen me analizat e mëparshme, kjo përdëfton se nevojitet zbatim i qëndrueshëm i rekomandimeve të dhëna, të plotësuara me udhëzime të reja. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit afatgjatë të anksiolitikëve për shkak të rrezikut nga varësia, vështirësive kognitive dhe efekteve sedative. Terapia duhet të jepet nën mbikëqyrje të rreptë mjekësore, me mundësi për ulje graduale dhe zëvendësim me qasje alternative.

Rekomandohet përforsimi i intervenimeve jofarmakologjike, si psikoterapi, aktiviteti fizik, teknika për përballje me stresin dhe programe të strukturuar psikosociale. Posaçërisht e rëndësishme është vendosja e ndërhyrjeve të rregullta individuale, grupore dhe familjare si dhe trajtim i intensifikuar për personat me rrezik të shtuar.

Në mënyrë plotësuuese nevojitet që:

- përmirësimi i përkrahjes psikologjike dhe i trajtimeve të rregullta profesionale;
- avancimi i programeve arsimore, sociale dhe i aftësive;
- përfshirja aktive e familjeve në procesin e risocializimit;
- angazhimi i kuadrit shtesë profesional dhe shfrytëzimi i resurseve të komunitetit;
- vendosja e protokolleve të qarta për trajtim farmakologjik dhe monitorimi i gjendjes shëndetësore;
- zhvillimi i protokolleve për trajtimin e varësive dhe gjendjeve abstinenciale;
- sigurimi i arsimit formal dhe i programeve për alfabetizim (zhvillimin e shkrim-leximit);
- nxitja e trajnimeve profesionale dhe bashkëpunim me ekonominë lokale;
- organizimi i aktiviteteve sportive dhe kulturore;
- edukim dhe supervizim i vazhdueshëm i personelit.

Si masa shtesë rekomandohet vendosja e skringjeve shëndetësore gjatë pranimit, përmirësimi i evidencës mjekësore dhe trajnimi i personelit për punë me fëmijë në rrezik

Tabela nr.2

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJEVE TË KONSTATUARA drejtuar Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve		
Nr. rendor.	Rekomandim:	Përgjigje:
1	Ndërmarrja e masave konkrete me të cilat do të sigurohet që fëmijët e gjinisë femërore, ndaj të cilëve me vendim të formës së prerë është shqiptuar masa edukative dërgim në institucion edukativo-korrektues, të vendosen në institucion mbi bazë të barabartë si edhe fëmijët e gjinisë mashkullore;	Duke pasur parasysh se është i nevojshëm ndarja fizike e hapësirës në IEK Tetovë me qëllim që të pamundësohet përzjerja e fëmijëve meshkuj dhe femra, ju informojmë se janë në vijim aktivitete për adaptimin dhe sigurimin e kushteve në IEK Tetovë, në mënyrë që edhe fëmijët e gjinisë femërore, ndaj të cilëve është shqiptuar masa e dërgimit në institucion edukativo-korrektues, të mund ta vuajnë masën në mënyrë të sigurt në këtë institucion. Gjithashtu, dëshirojmë të shtojmë se me kontratë në vepër janë angazhuar dy persona të gjinisë femërore si pjesëtare të policisë së burgut, të cilat kanë kaluar trajnim (me mentorë) në seksionin e grave në INK Idrizovë.
2	Plotësimi i kuadrit profesional në të gjithë sektorët organizativë, si dhe organizimi i trajnimeve të specializuara për të punësuarit në Institucion lidhur me veprimin dhe trajtimin e fëmijëve në rrezik dhe fëmijëve në konflikt me ligjin;	Është e domosdoshme rritja e numrit të të punësuarve në të gjitha institucionet, përfshirë edhe IEK Tetovë. Në bazë të nevojës për punësime që kanë institucionet dhe planeve vjetore për punësim që secili institucion, në pajtim me ligjin, i dorëzon në Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve, përpilohet Raporti i Përbashkët Vjetor për punësim në të gjithë sistemin penitenciar dhe i njëjti dorëzohet në institucionet kompetente për marrjen e pëlqimit për punësim. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se ekziston dallim i madh ndërmjet nevojës për punësime të reja që ne si Drejtori për Ekzekutimin e Sanksioneve e identifikojmë dhe e pasqyrojmë në Raportin e Përbashkët Vjetor për punësimin e personelit penitenciar, dhe pëlqimeve që merren. Konkretisht për IEK Tetovë, sipas Planit Vjetor për punësim dhe avancim të personelit penitenciar për vitin 2025, janë miratuar vetëm dy avancime.

		<p>Sa i përket trajnimeve, ju informojmë se të punësuarit nga seksioni për trajtim në IEK janë njoftuar me Programin për aftësi të buta jetësore në kuadër të projektit „Forcimi i procesit të rehabilitimit dhe riintegrit të fëmijëve në sistemin e drejtësisë për fëmijë” (SPPMD dhe UNICEF). Programi zbatohet si pjesë e punës grupore me fëmijët. Për më tepër, të punësuarit morën pjesë edhe në punëtori konsultative për programe të drejtësisë restauruese dhe programe për parandalim/riintegrim të fëmijëve në rrezik dhe fëmijëve në konflikt me ligjin në kuadër të projektit „Drejtësi për fëmijë”. Janë realizuar aktivitete për trajnim dhe njohje me këto programe. Implementimi i tyre formal në IEK Tetovë ende nuk është vendosur.</p> <p>Në drejtim të forcimit të trajtimit dhe kujdesit për fëmijët, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve lidhi Memorandum bashkëpunimi me Qendrën për iniciativa sociale „Nadezh”, në kuadër të të cilit do të zbatohen: programe edukative, trajnime për recidivizëm, trajnime për aftësi jetësore, programe mentorimi, programe për prindërim dhe familje.</p> <p>Në pajtim me programin ekzistues të trajnimeve, nuk disponojmë kapacitet adekuat për zbatimin e trajnimeve të specializuara, por në të ardhmen do të kërkohet ndihmë profesionale nga ekspertë të jashtëm, të cilët do të mund të organizojnë trajnime për trajtim dhe mbështetje të fëmijëve në rrezik.</p>
3	<p>Në komunikim dhe koordinim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të ndërmerren masa urgjente për përfshirjen e fëmijëve në procesin e arsimit formal.</p>	<p>Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin fillor („Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 3/2025) është paraparë që Shkolla Fillore për të Rritur „Anton Semjonoviç Makarenko” Shkup, e cila fiton statusin e shkollës shtetërore, duhet ta realizojë arsimin fillor të fëmijëve në institucionet edukativo-korrektuese. Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve përgatiti Analizë të gjendjes lidhur me shkallën e arsimit të personave në INK dhe IEK, e cila është dorëzuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës si bazë për organizimin e vitit shkollor 2025/2026.</p>

Tabela nr.3

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJEVE TË KONSTATUARA drejtuar IEK Tetovë		
Nr. ren-dor.	Rekomandim:	Përgjigje:
1	<p>Të ndërmerren masa për lehtësimin e qasjes në Institucionin Edukativo-Korrektues, si për shembull komunikimi me autoritetet lokale për vendosjen e një linje të rregullt dhe të shpeshtë autobusësh, si dhe komunikimi i drejtpërdrejtë dhe mbështetja në organizimin e vizitave për anëtarët e familjeve dhe persona të tjerë të afërt të fëmijëve të vendosur në Institucion;</p>	<p>Organizimi i transportit publik me autobus dhe përcaktimi i linjave të autobusëve është në kompetencë të vetëqeverisjes lokale. Për këto arsye, në disa raste janë realizuar takime pune me kryetarin e Komunës së Bërvenicës, në të cilat, krahas çështjeve të tjera, është diskutuar edhe kjo temë. Nga autoritetet komunale nuk është marrë përgjigje pozitive për organizimin e transportit publik. Për këtë arsye, së bashku me Shoqatën e Qytetarëve „Rubikon-Shkup“, në kuadër të projektit „Mbështetje për fëmijët në konflikt me ligjin“, është realizuar aktiviteti projektues për organizimin dhe zbatimin e vizitave nga familjet biologjike, përkatësisht kujdestarët dhe anëtarët e familjeve të fëmijëve që qëndrojnë në Institucion gjatë viteve 2022 dhe 2023. Me këtë rast, nga Shoqata e Qytetarëve „Rubikon-Shkup“ është organizuar transport për të gjithë fëmijët, prindërit, kujdestarët ose anëtarët e familjeve të të cilëve kanë shprehur interes dhe dëshirë për të realizuar vizita në Institucion dhe takime me fëmijët e tyre, si dhe biseda me personat profesionalë të Institucionit. Gjithashtu, nga udhëheqësi i seksionit për trajtim, përmes një shkrese drejtuar Qendrave kompetente për Punë Sociale, është iniciuar ndarja e ndihmës së njëhershme financiare për familjet në rrezik financiar, me qëllim realizimin e takimeve me fëmijët e tyre të vendosur në Institucion.</p>
2	<p>Të rishikohet Udhëzimi për përgjegjësi disiplinore në drejtim të përcaktimit të të drejtave që i ka fëmija gjatë procedurës disiplinore, veçanërisht në lidhje me mundësinë e paraqitjes së ankesës kundër vendimeve të drejtorit për shqiptimin e masës edukative, si dhe në lidhje me përfaqësimin e fëmijës në procedurë;</p>	<p>Bëhet fjalë për një gabim teknik, pasi në Arsyetimin e Aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore, të cilin e nxjerr drejtori, në UDHËZIMIN JURIDIK është përcaktuar se kundër Aktvendimit fëmija ka të drejtë ankesë në afat prej 3 (tri) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. Aktualisht po punohet në harmonizimin e të gjitha akteve nënligjore me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, me ç'rast do të korrigjohet edhe ky gabim teknik.</p>

3	<p>Të lëshohet urdhër për të gjithë të punësuarit se është rreptësisht e ndaluar të përdoret çfarëdo force ose mjeteve shtrënguese ndaj fëmijëve jashtë kushteve të parashikuara me ligj, si dhe të theksohet qartë ndalimi i goditjes së fëmijëve me shuplaka për shkak të sjelljes së tyre;</p>	<p>Të gjithë të punësuarit veprojnë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Rregulloren për kushtet më të afërta dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve të shtrëngimit nga pjesëtarët e policisë së burgjeve në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukativo-korrektuese.</p>
4	<p>Të sigurohet që çdo përdorim i forcës dhe i mjeteve të shtrëngimit, përfshirë edhe mjetet e lidhjes (prangat), të evidentohet dhe të jetë objekt vlerësimi për arsyeshmërinë e përdorimit të tillë;</p>	<p>Veprohet në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Rregulloren për kushtet më të afërta dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve të shtrëngimit nga pjesëtarët e policisë së burgjeve në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukativo-korrektuese.</p>
5	<p>Të zhvillohen protokolle për menaxhimin e krizave të abstinencës me barna përkatëse për këtë qëllim ose, nëse është e nevojshme, të sigurohet terapi zëvendësuese me Methadone ose Buprenorphine;</p>	<p>Në pajtim me Procedurat Standarde Operative për sigurimin efikas të mbrojtjes shëndetësore në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukativo-korrektuese, Ministria e Shëndetësisë siguron nivelin optimal të mbrojtjes shëndetësore për çdo person të privuar nga liria, si dhe zbatimin e parimit për sigurimin e mbrojtjes së barabartë shëndetësore në INK/IEK.</p> <p>Nga kjo rezultojnë kompetente për organizimin dhe zbatimin e mbrojtjes shëndetësore në INK dhe IEK është Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht mjekët dhe punonjësit shëndetësorë që ofrojnë shërbime në institucionet penitenciare, përkatësisht edukativo-korrektuese.</p> <p>Rrjedhimisht, rezultojnë edhe përfundimi se zhvillimi i protokolleve për menaxhimin e krizave të abstinencës me barna përkatëse ose, nëse është e nevojshme, sigurimi i terapisë zëvendësuese me Methadone ose Buprenorphine, bën pjesë në aktivitetet dhe kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë.</p> <p>Vendosja e protokolleve për përshkrimin e terapisë psikofarmakologjike të fëmijët, si dhe ndjekja elektronike e ditëve mjekësorë, e terapisë së përshkruar dhe e gjendjes shëndetësore, janë çështje që duhet t'i adresohen ministrisë kompetente, përkatësisht Ministrisë së Shëndetësisë.</p>

6	Trajtimi i fëmijëve me barna psikotrope të miratohet edhe me pëlqimin e prindit ose të kujdestarit ligjor.	Lidhur me rekomandimin që mjeku të marrë pëlqimin e prindit ose të kujdestarit ligjor për trajtimin me barna psikotrope, ose, nëse të drejtat prindërore janë ndërprerë, vendndodhja e prindit është e panjohur apo prindi/kujdestari ligjor refuzon të japë pëlqimin, të sigurohet miratim gjyqësor, IEK Tetovë ka nevojë për udhëzime se si të veprojnë, për shkak se i gjithë dokumentacioni mjekësor, procedurat dhe rezultatet e ekzaminimeve të ndryshme mjekësore janë konfidenciale dhe mund të shihen vetëm nga punonjësit shëndetësorë.
---	--	---

SPITALI PSIKIATRIK DEMIR HISAR

